

Flori Bruqi

VRASESIT E LIRIDONËVE

VRASESIT E LIRIDONËVE

Flori Bruqi





**Biblioteka e romanit shqiptar**  
**LUMI I BARDHË**

**Redaktor**

**MEHMET KAJTAZI**

**Recensues**

**DAUT DEMAKU**

**Lektore**

**DRITË NIMANI**

**Korrektor**


**ENVER SYLEJMANI**


**FLORI BRUQI**


**VRAŠËSIT  
E LIRIDONËVE**

(Roman)

**FLOMED**  
Prishtinë  
1996







## PROLOGU

- Alo, Abdylaziz Hylloshi po më duhet.
- Gabimisht keni thirrë, alo... këtu nuk është Abdylazizi. (*sqarim për emrin tim*)

Prindërit më kishin pagëzuar Abdylaziz. Emri im ishte shënuar në ditar të shkollës fillore, në ditar të shkollës së mesme, në letërnjoftim, në pasaportë, në amzë të të lindurve. Kur u regjistrova në fakultet më lindi edhe më shumë dëshira që të bëhem mjek, më shkoi mendja edhe te amza e të vdekurve. Isha një entuziast i çuditshëm: dëshiroja që kjo bota jonë të ketë vetëm amza të të lindurve, por që kur kishte amza të të lindurve, kishte edhe amza të të vdekurve. Çdokund është shënuar emri im, të cilil nuk dua t'ia mësoj fare kuptimin, nga të

gjitha anët më duket emër pa kuptim, emër tepër i huaj, i madh, as nuk është ndalë te emri i parë Abdyl, as te emri i dytë Aziz, por dy këta emra janë bashkuar që t'i barti deri në ditën kur hapet amza e të vdekurve. Disa më quajnë Abdyl, disa Aziz, Unë thashë t'ia bëj një reduktim emrit tim, ia bëra, i mora dy shkronjat e para të emrit të parë, i bashkova me dy shkronjat e para të emrit Aziz dhe më doli prapë një emër i çuditshëm: Abaz, jo vetëm i çuditshëm, por i frikësueshëm dhe tepër trubullues sa emri Abdullah. Abdullahu shkoi një ditë në shkollë për pilot, nuk e kreu këtë shkollë, babai i thoshte se ti gomarit ia humb udhën, e lëre më avionit. Pra - Abdullahu shkoi në Suedi, unë mbeta në Kosovë, ku e di unë e ka ndërruar apo nuk e ka ndërruar emrin, por unë mund t'iu tre-goj se hoça dorë përfundimisht edhe nga emri Abaz. Në indeksin tim nuk doja ta shih-ja as emrin Abdylaziz, as Abdyl, as Aziz, as Abaz. Doja një emër krejt tjetër. Fillova për t'i rregulluar dokumentet, sikur kisha harruar se administrata e Sundimtarit të kuq është aq e ngatërruar për ndërrimin e em-

rave, sa njeriu që i hyn kësaj pune e sheh në njëqind mënyra amzën e të vdekurve. Mbi-emrin e doja shumë, më dukej mbiemri më i bukur në botë. Ti vetëm emrin ke vendosur ta ndërrosh? Ishte pyetja e shtatëmbëdhjetë që më bëhej nëpër zyra të ndryshme. Mbi-emrin nuk dua ta ndërroj, por vetëm emrin. Po cilin emër ke zgjedhur ti? Unë i tregova nëpunësit që i përvoli mëngët e zeza mbi një këmishë të bardhë, ia shikova syzat që i ndërronte, sytë edhe më shumë iu turbulluan kur i thashë se unë prej sot do të quhem Alban. Punë që nuk bëhet, pse nuk pagëzohesh me emrin e Maksutit, pastaj mund t'i kesh edhe këta emra, zgjidhe cilin të duash: Hajdăr, Sultani, Karamaksut, ose vetëm Maksut, Galip etj. etj. etj. Nuk ka krizë të emrave, por ka krizë ekonomike, e sheh inflacioni ç'bëri, pastaj e sheh sanksionet e botës ku na quan, tërë bota është ngritur kundër nesh, krizë tepër e madhe politike dhe ekonomike, ekonomike...

Krizën politike e përmendi nëpunësi i Sundimtarit të kuq me majë të gjuhës, por krizën ekonomike e shqiptoi me zë të lartë.

Unë i kisha njëqind marka gjermane që m'i kishte falur babai, i shtrina në suprinë të tavolinës, ai u shti sikur nuk i pa, i bashkoi me dokumente të tjera. Ishin tridhjetë e më shumë dokumente, më tha që të pres në korridor. U krye puna, thashë në heshtje, këta nëpunësit e Sundimtarit të kuq janë në gjendje për njëqind marka që ta ndërrojnë jo vetëm emrin, por edhe mbiemrin, janë në gjendje që të heqin dorë edhe nga rrënja e Sundimtarit të kuq po ia vure dyqind marka në suprinë të tavolinës, por unë nuk doja asgjë më shumë, pos ta ndërroj emrin tim dhe ta shoh Albanin në indeksin tim.

Alban! - më thirri nëpunësi, - ti prej sot nuk je më Abdylaziz, por je Alban, e di se është një emër që nuk e ka në qejf askush nga nëpunësit e Sundimtarit tonë, por paske që-lluar djalë me fat, e ndërrove emrin. Alban, - m'u afrua te veshi nëpunësi që ma lëshoi në dorë certifikatën e re të lindjes, Kosova ishte juaja, është juaja do të mbetet juaja, ne jemi përkohësisht këtu, unë për vete e kam rregulluar punën: e kam ndërtuar një shtëpi të re në Beograd, duhet të punoj edhe një vit e

pastaj pensionohem dhe bashkë me familje shkoj në shtëpi të re.

Ti i di punët tuaja, i thashë nëpunësit, u ktheva në shtëpi shumë i gjëzuar. U gjëzua edhe babai, u gjëzua edhe nëna, vëllezërit, si më të rinj që ishin, i kishin emrat shqip, edhe motrat poashtu, motrat dhe vëllezërit u gjëzuan edhe më shumë. Nuk kaloi kohë e gjatë e të gjithë u mësuan me emrin tim të ri. Emri im i vjetër u bë edhe më shumë i huaj për mua dhe për të gjithë ata që më quanin me emër të ri, e ky që më thirri në telefon me emër të vjetër, më provokoi, apo është ndonjë injorant që pandeh se emrat vijnë nga qielli. Ai më thirri për të dytën herë:

- Alo, dua të bisedoj me Abdylaziz Hylloshin.

- Abdylaziz Hylloshi ka vdekur, me njeriun e vdekur si mund të bisedosh.

- Nga Suedia po thërras, Abdullahu jam, ndjesë pastë, por çuditërisht i njëjtë zë si i Abdylaziz Hylloshit.

Unë i sqarova Abdullahut për ndërrimin e emrit tim. Do ta ndërroj edhe unë, - tha ai, - s'kam rrugëdalje tjetër. Në kampin

e azilantëve janë shtatëmbëdhjetë Abdulla-  
ha, asnjëri prej tyre s'e ka parë shoqi-shoin  
në fëmijëri, se të gjithë janë rritur të ndarë  
në shtete të ndryshme, por të gjithë e kanë  
një veti të përbashkët: nuk i lajnë këmbët  
para se të flejnë, higjenistja të gjithë i ka  
mallkuar, u ka thënë se me polici do t'i de-  
tyrojë që t'i lajnë këmbët para se të flejnë,  
ose me polici do t'i detyrojë të kthehen në  
shtetet nga kanë ardhur. Po çfarë emri do të  
kesh, more Abdullah? Hëpërhë nuk di, por  
nga emri Abdullah kam hequr dorë përgjithmonë, ty urime që e paske pagëzuar  
veten kaq mirë, - dhë u këput lidhja me  
Suedinë.

Unë, Alban Hylloshi, emri im tash është  
në letërnjoftim të ri, në pasaportë të re, në  
librin e të lindurve, në diplomë të fakultetit  
të mjekësisë, në tregimet që i kam botuar. Sa  
mirë që asnjë tregim nuk e kam botuar me  
emrin Abdylaziz. Unë, Alban Hylloshi, në  
prag të zyrës së shtatë të Sundimtarit të kuq  
e hoça dilemën rrëth emrit tim. Në fillim  
doja që pasi të heq dorë nga emri i huaj  
Abdylaziz, të pagëzohem me emrin Liridon,

por e dija se unë nuk mund të jem as hija e Liridon Gjëmëmadhës, andaj, po them edhe njëherë, dilemën e hoqa në prag të asaj zyreje. Alban do të quhem, thashë, dhe nisa të shkruaj një tregim të gjatë për Liridonin. Në Kosovë, që nga viti kur Sundimtari i kuq e pushtoi Kosovën, lindi një emër klithës: LIRIDON. Nuk ka fshat në Kosovë që s'e ka së paku një Liridon. Në Shqipëri, sa mirë, nuk ka fare Liridona, sepse kur përfundoi Lufta e Dytë Botërore përfundoi edhe dëshira e nënave për emra klithës. Kush e ka lirinë, s'i duhet emri klithës, më tha babai. Nëna, ndjesë pastë, më kishe thënë një vit më parë.

## (LIRIDONI OSE ORFEU)

Derisa më lindi ideja të shkruaja këtë libër, më erdhën në mendje shumë gjëra, ndër to edhe Gjea - Tokë, që sipas kozmonogonisë së Hesiodit, është personifikim tokës në formim e sipër. Menjëherë pas Kaosit ajo doli një ditë nga asgjësia dhe lindi një djalë, Uranin. Mua Urani më dukej s' Liridoni i tokës sime - i pavdekshëm. Në këtë libër me Liridonin u bashkuan shumë shokë që patën të vetmin qëllim: ta bëjnë këtë tokë të lirë: të lumtur e më krenare. Në këtë libër hyri edhe nëna Ajkunë, që kish lindur dragonj që s'i përkuleshin askujt. Gjea - Tokë, te unë Nënë Ajkuna, si nëna e përbashkët e dragoneve, pati një rëndësi të madhe për një popull e për një tokë me emrat Kosovë a

Dardani. Nënën Ajkunë e adhuroj si nënën time, si të gjitha nënët që lindin fëmijë e që bëhen theror për liri.

Në mendim e sipër, derisa po thurja ngjarjen për librin, m'u kujtua edhe fjala Gjeniu, që ishte forca shpirtërore dhe e gjallë e njerëzve dhe e perëndive. Romakët e vjetër mendonin se çdo qenie e gjallë shoqërohej nga gjeniu i vet, hyjnia individuale që i shkonte pas që nga lindja e deri në fund të jetës. Te unë gjeniu ishte mbrojtës jo vetëm i burrave, po edhe i nënave, i fëmijëve, i tokës e i luleve, i malit e i fushës, i krojeve e i lumenjve, i parqeve e i gëzimeve. Gjeniu ishte mbrojtës i të gjitha virtyteve njerëzore. Ky ishte Liridoni, për të cilin nuk më merrte gjumi. Ëndërroja të shkruaja diçka për të, po si të shkruaja unë për Gjeniun, Poetin, Kërkuesin e Lirisë! A do të kisha fuqi të fuqizoja shpirtin e tij, këngën që përhapte fushave, zellin për të njësuar shpirtin e tij me të popullit! Për të gjitha këto më mundonte ndjenja fisnike që kisha për të, për mësuesin, shkrimtarin e këngëtarin, për zogun që ai e shihte në kuvli, për flamurin që

i rrinte i ndrydhur, për ëndrrën e tij të madhe për t'u nisur rrugës ngadhënjimtare, për të arritur te Shpresa, te Caku, te Ylli i tij, që do të shkëputet një ditë po që nuk do të shuhet kurrë. Dhe mora guximin se qesh takuar disa herë me Nënën Ajkunë dhe ajo ma fali u ximin e bekimin që të bëj përpjekje sado modeste për të portretizuar atë fytyrë të pagjumë, atë njeri që herë pas here më dukej se ishte si Orfeu. Ky Orfeu më ngjante me Liridonin tim, sepse edhe ky pat marrë nga populli si dhuratë një ëndërr me shtatë tela, edhe për këtë ka legjenda që do të tregohen brez pas brezi.

Libri im për Orfeun tonë le të jetë i hapur mu tashti kur e ke dëshirën më të madhe për ta njobur më mirë...

"Baladën për J..." donte ta dëgjonte edhe një herë Abdullahu në Suedi, e kishte thirrë në telefon edhe nënën e vet në fshat, i kishte thënë se ka qajtur kur e ka dëgjuar këtë baladë, më kishte pyetur edhe mua Abdullahu nga Suedia e kisha dëgjuar, apo nuk e kisha dëgjuar këtë baladë. Vetëm një herë e kam dëgjuar, i sqarova në telefon Abdu-

llahut në Suedi, dhe i tregova se ka ardhur një kohë e mjegullt, shqiptarët po ikin nga Shqipëria, shqiptarët po e shajnë Shqipërinë, andaj edhe nga Radio Tirana kanë ikur edhe baladat. Shqiptarët do të kthehen prapë në Shqipëri. Të gjithë ata që ia kanë kthye shpinën Shqipërisë, dhe kanë ardhur në Suedi, kanë thënë se do të dëshironin të ktheheshin prapë në Shqipëri, do t'ia thithnin me gjuhë pluhurin rrugëve të Tiranës vetëm që të kthehen. E kush ju ka mashtruar që erdhët në këtë shtet kaq të largët?

O, Abdullah, më tha një mësues nga Tirana, unë e di se ti ke ikur nga Sundimtari i kuq dhe ke ardhur në Suedi, ke dashur që të kthehesh posa ke marrë lajmin se vdiq dhe u varros Sundimtari i kuq që e ka pushtuar Kosovën, menjëherë posa përfundoi Lufta e Dytë Botërore, por Shqipëria prapë do t'i kthejë shqiptarët, se ata që ikën me anije dhe kërcyen nëpër male e kodra ishin njëherë të mashtruar, pastaj të uritur për t'i prekur me dorë edhe yjtë në qiell. Kishte ikur uria, kishte hyrë prapë mashtrimi i madh, njerëzit nuk dinin se trashëguesi i Sundimtarit të kuq

në Beograd ishte përbetuar pranë varrit të mermertë të Sundimtarit të kuq, mu aty ku shtetarët e tërë botës bënin teatër dhe shtreshin se po e nderonin varrin e tij, i vënин kurorat e luleve me kujdes, pra edhe pranë atyre luleve trashëgimtari i Sundimtarit të kuq ishte përbetuar që Kosovën ta bënte pa shqiptarë, por edhe nga Shqipëria të largonte sa më shumë shqiptarë, sepse donte të dilte një ditë edhe në Vlorë. Edhe "Balada..." iku një ditë nga sytë e tij...

## (DIELLI SHIKONTE DIELLIN)

Natë gushti. Kalorësi me flokët që i derdheshin supeve sapo arriti në një kthesë rruge, në skajin lindor të tokës amëtare. U ngrit mbi kalë për ta parë edhe më mirë hijen e Bjeshkëve të Nemuna, në atë hije shihte mortajën që kishte ardhur nga veriu. E ngriti edhe një herë kokën, pastaj u përul mbi zverkun e kalit, ia lëmoi jelën, diçka i foli në vesh. Një re pluhuri u ngrit drejt hijes së Bjeshkëve të Nemuna. Pluhurin nuk e shihte askush. Nata në Dubovik po tretej. Një dritë e venitur edhe më shumë venitej nga terri dhe pluhuri që nuk dukej. Drita dukej si pëlhirë avujsh në lagjen Gjémëmadhja. Edhe të parët e kësaj lagjeje kishin biseduar si t'i ndërronin emrin lagjes, edhe brezi më i

ri kishte thënë se kur t'i hiqet gjëma lagjes dhe t'u hiqet Bjeshkëve të Nemuna hija që kishte ardhur nga veriu, lagjja mund të marrë një emër tjetër.

Kalorësi vraponte pa u lodhur, dhe, ja, u gjend në udhën që del nga përroi dhe shtrihet, i qeshur dhe i gjëzuar, në rrafshin e valëzuar të Zabelit. E ndali pakëz kalin dhe hodhi sytë drejt Majës së Strellsës. Atje pa edhe hijen e vet të fëmijërisë tek po kulloste kuajt e t'et e të njerëzve të tjerë të fshatit e tek po u dilte përpara një ujk. Ai nuk trembej nga ujku. E kishte mësuar nënë Ajkuna që të mos trembej nga ujku. Ajo ia kishte këputur me sëpatë kokën një ujku me dhëmbë të përgjakur. E kishte tërhequr zvarrë nga hija e Bjeshkëve të Nemuna atë ujk, fshatarët e Dubovikut ishin gjëzuar. Tutje, te Lugu i Shtrigave, kishte shumë lisa, një ditë fja-fueshëm iku hija nga Bjeshkët e Nemuna, brenda zgavrës së një lisi fshatarët gjetën shumë gjarpërinj. I zhdukën, por gjëzimi nuk zgjati shumë. Gjarpërinjtë ishin fshehur edhe brenda trupit të mocëm të një bliri. Në hijen e vet të fëmijërisë ai po shikonte edhe

atë bli, po shihte edhe të vëllanë që e porosištë që të ikte mënjanë derisa të shfaroseshin gjarpérinjtë. Gjarpérinjtë nga një zgavër e padukshme kishin dalë nga bliri dhe kishin vërshuar pllajën. Pllajës iu dëgjua vaji i luleve, ai nuk u përbajt, rrëmbeu me të dyja duart një degë të blirit, dega që kishte filluar të thahej nisi t'i mallkojë gjarpérinjtë. Ata ishin shkaktarë të vetëm pse ajo ishte tharë. Brenda hijes së vet ai shihte prapë të vëllanë që kthehej nga një lagje tjetër, ku kishte shkuar për të marrë një çifteli. Do të këndonte në dasmën e Demës. Matanë përroit u duk një çetë cerberësh. Çeta ishte veshur me hije të zezë. Çeta e zezë çau pyllin e Broliqit, i afrohej vaut. Çeta e zezë ecte drejt Dubovikut, në krye të çetës kishte una me zjarr, në mes të saj po ashtu, zjarr kishte më shumë në fund të çetës. Çeta e zezë donte ta digjte fshatin, unat ishin drejtar për në lagjen e quajtur Gjémëmadhja. Ku ishte koka e çetës së zezë? Ku ishte bishti i saj? Edhe njëqind pyetje mund t'ia bënte vëllai vëllait, por kokën s'do ta gjenin në afërsi të Bjeshkëve të Nemuna. Koka e kësaj çete

është në Karpate, i tha vëllai vëllait, ka dëgjuar për dasmën e Demës, andaj ka ardhur që të mos kemi gëzim.

- Ç'duhet bërë?

- Demo, lajmëro me nxitim fshatin për ardhjen e çetës së zezë.

Dema e dinte fare mirë se dasmë nuk mund të ketë, ngase zjarri sa nuk i kishte prekur bredhat e fshatit. Çeta prapë ecte drejt plepave, e ata dukeshin tamam si flokët e fshatit. Fshati e shihte shtëpi më shtëpi Demën. I kishte ikur gëzimi. Kalorësi shihte në hijen e vet rrrokullisjen e gurëve nga Bjeshkët e Nemuna, Gurët qëllonin në koka të kërxhallinjve. Pirgu i çetës së zezë nisi të përmbysej në Dri. Drini eci drejt Kukësit, donte t'i lajmëronte Drinit të Zi se çeta e zezë nuk mundi t'ia ndalë hapin Drinit të Bardhë...

Në hijen e vet ai shihte edhe plagën në këmbë. Shihte edhe shtatë varre të reja në lagjen Gjëmëmadhja. Gjëma iu shtua tërë fshatit, ajo u dëgjua edhe në brigje të Drinit të Zi, njerëzit vrapanan për t'i shpëtuar njerëzit pranë Drinit të Bardhë. Bisedonin

dy lumenjtë pér nusen e Demës. Ajo po shikonte me duar në faqe nga parmaku i dritares. Dema po vraponte pas një cerberi përbindësh. Kalorësi në hijen e vet të fëmijërisë po shihte edhe kthimin e Demës nga lufta. Ishte ditë e shtunë kur ishte kthyer, vinte plot lavdi, në duar mbante flamurin e kapedanit, dubovikasit i hidhnin lule edhe kalit të tij qimebardhë. Lulet nuk ia tretnin zymtësinë dhe pikëllimin. Ai kishte parë shumë varre të reja në lagjen Gjëmëmadhja. Kali i tij ishte shumë i kujdeshshëm ndaj luleve. Edhe kur ecte ngadalthi, edhe kur vraponte nuk e shkilte asnjë lule. Iu afrua shtëpisë si një hije e lulës së këputur.

Prapë do t'i ndjek shkelësit e tokës sonë, i tha pragut të shtëpisë, e dera ishte e hapur. Dielli shikonte një diell në mes të oborrit...

## (E BUKURA FSHIHET NË THELLËSI)

Shtëpia me oborr ku shikoheshin dy diej dukej në krenarja, ndonëse kishte çati të moçme dhe shiu do të mund të pikërronte edhe në djepin që do të përkundet nesër. Liridoni që ishte zgjuar para diellit, vështronte nga dritarja shiun që binte i praruar në pisha të Bjeshkëve të Nemuna. Dëshiron te që ai shi të vinte edhe në lagjen Gjëmëmadhja, por nuk vinte. Dielli shikonte sytë e tij të kaltër dhe majën e Strellsës.

- U zgjove?

Zëri i butë i nënë Ajkunës tingëlloi si zëri i bletës mbi një lule të vetmuar që e pehat edhe puhiza. Liridoni nuk foli, u kthyesh me sy kah nëna, e puthi në faqe. Nënë, i tha,

po të zgjohesha më herët do ta lëroja një copë bukur të madhe të arës. Dita është mjaft e gjatë, biro, i tha ajo. Liridoni e pyeti nënën është zgjuar, apo është ende në gjumë babai. Pak më parë u ngrit, tha ajo, dhe sqaroi se edhe Genci ka shkuar në punë të vet, e edhe Trimi gjithashtu.

Edhe nënë Ajkuna shkoi në punë të vet, pas pak u kthyte me një gotë qumështë të vluar. Sofra e Liridonit kishte edhe një gashëtër djathë, e po kjo sofër shihte gjelin e lidhur në këmbë të magjes...

Gjeli do të bëhej drekë e shijshme...

Udha tepër e largët, biro, i tha nëna të birit, thonë se Jesenica është pas shtatë bje-shkëve, por mua më duket se është pas shtatëdhjetë bjeshkëve. Është tokë e huaj, e rruga në tokë të huaj është edhe më e gjatë. Toka e huaj jo vetëm që t'i ngatërron hapat dhe ta humbë udhën edhe në livadh, e lëre më në mal, por ajo edhe të lë të uritur. Hiqe urinë, bir, se edhe unë do ta heq mallin për ty, më erdhe, nisa qysh mbrëmë që të çmalllem. S'kam uri, nënë, vetëm për bukë e qumësht...

"Kur tē hiqet uria ty, more bir"?

"Kur t'i hiqet gjëma lagjes sonë, nënë".

U shikuan sy më sy.

Nënë Ajkuna foli:

"Tërë Kosova është me gjëmë, o bir":

Prapë u shikuan sy më sy.

Kalorësi shikonte prapë hijen e vet në Bjeshkë të Nemuna. Hija zgjatej edhe te bliri i fshatit. Është bliri i barinjve. Sa ishte përmalluar Liridoni që ta shihte. Kalorësi shikonte prapë dymbëdhjetë vajza që ia stolisnin degët blirit të mocëm. Njëra prej vajzave që e vuri lulen majë blirit nisi të këndojoë:

*"Moj e mira n'ato maje"*

*Rritju bacit dalëngadale,*

*Boll jam rritë nuk rritem tjetër,*

*Jam si lira e pështjellë në letër"...*

Vajzat e tjera qeshën, por kishin pakëz mëni ndaj vajzës që këndoi. Ajo ishte më e shpejta, e para do të shkonte nuse. Liridoni i largoi sytë nga sytë e nënës së vet, e vuri buzën në gaz. Zëri i Dafinës, tha ai, zëri i

Dafinës vet. Atë zë e njoju edhe nënë Ajkuna. Ajo tha se duhet të martohen edhe Donikë e edhe Dardanja, të gjitha vashat tonë duhet të martohen, të lindin sa më shumë fëmijë. Sa më shumë fëmijë që të ketë tokë jonë aq më pak gjarpërini do të ketë kjo tokë. Do të martohen edhe të gjithë djemtë tanë, tha nënë Ajkuna, do të kemi shumë fëmijë, kur kemi shumë fëmijë, kemi më pak gjëmë. Tërë nata më shkoi me një ëndërr me gjëmë, nënë Ajkunë. Gjarpérinjtë që ishin mbështjellë në lëkura të zeza, i kafshonin fëmijët në djepa. Ti vrapoje prapë në mal, e preje një lis për të bërë një djep të ri, gjarpérinjtë fshiheshin në degë të tij, e ti e shkundullove lisin, gjarpérinjtë ranë në zjarr. Nuset u gëzuan, u gëzua edhe bliri i fshatit, pranë degëve të tij vashat dhe djemtë nisën të vallëzojnë. Dola nga ëndrra, e hapa dritaren, në parmak të saj ishte një gjarpër i zi, u ngrit drejt syve të mi, nisi të flasë...

"Gjarpéri të flasë në dritare?!"

...Nëna Ajkunë, gjarpéri që më kishte ardhur në dritare kishte kokën e njeriut,

dhëmbët e ujkut, qimen e djallit, e mbante një ylber në duar, prapa ngjyrës së ylberit kishte një thikë, e në majë të saj ishte shkronja S. Kjo shkronjë nxirrte zjarr, zjarri fluturonte drejt syve të mi. Për një çast u ndal flaka, gati sa nuk u shua kur edhe më shumë u përhap zëri i Daфинës:

*"Nuk jam lirë, po jam dukat  
Po t'shoh èndërr natë për natë!"*

Gjarpëri ik nga kënga jonë, o bir, tha nënë Ajkuna dhe i bërtiti gjelit që i mashtronte pulat dhe e lëvizte magjen. Edhe në sytë e saj të gështenjtë hyri thika me flakë...

"Nënë, ti po dridhesh".

Ajo prapë dridhej.

Ajo shihte kokën e gjarpërit që po e kafshonte birin e saj...

"Nënë, ti po dridhesh".

Liridoni u mburr:

"Gjarpër që më kafshon mua nuk do të ketë..."

Nëna e përqafroi të birin.

Nga Luginà e Shtrigave po vinte Trimi. Ai e pa të vëllanë nga larg, nuk i hetoi hapat që nxitonin.

"Baci Liridon! - tha ai, poshtë në përrua të zi ka hyrë Pitoni i Madh. Pitoni është në krye të çetës së zezë.

Trimi shikoi edhe një herë të vëllanë, shikoi edhe sytë e nënës së vet, ajo nisi prapë të dridhej, e bëri dorën strehë, sytë e saj shihnin një njeri me gungë të madhe në shpinë, gunga e tij dukej si një copë e shkëputur e gurit të oxhakut, prapa atij guri zgjateshin dy duar të gjata, ato lidheshin me Pitonin. Pitoni i Madh i Karpateve është bashkuar me duart e kukudhit të tokës sonë, haram o toka jonë që rrite kukudhin me gungë në shpinë!

Liridoni vrapi drejt tyre, pas tij vrapi Trimi, nënë Ajkuna u shtang në këmbë. Vetëm një natë pushove nga udha e largët, o bir, iu foli ajo Bjeshkëve të Nemuna, por zëri i saj nuk dëgjohej më larg se te bliri i fshatit. Çlodhja ime është si çlodhja e erës, u dëgjua zëri i Liridonit, i cili ngjitej majë Bjeshkëve të Nemuna, donte t'i rrrokulliste gurët e saj

mbi koka tē Pitonit e tē kukudhit. Prapa tij ngjitej Trimi.

Dy vellezërit s'e shihnin më nënën....

Ajo ishte ngrirë në këmbë siç ishte ngrirë bliri në rrënëtë veta.

Nuk dukej më as Pitoni i Karpateve, nuk dukej më as kukudhi i tokës sonë, por dukeshin gjarpérinjtë e tyre me zjarr në gojë. Ishin nja njëzet, tē gjithë ishin veshur me rroba tē kaltra, në errësirë dukeshin tē zeza.

- Ku është shtëpia e Liridonit? - pyeti ai që i printe kolonës, kishte mustaqe tē zeza dhe sy në gropë.

Nënë Ajkuna heshti.

- Liridoni vrapi për t'ia rrëmbyer një rreze diellit, - tha Dafina.

- Diellin e Liridonit ne e shkelim me këmbë, - tha ai që i printe kolonës.

Nënë Ajkuna iku nga heshtja e vet, u ul në një guri në strehë tē shtëpisë, dhe lëvizte kërrabëzat...

- Po thur vdekjen e djemve tuaj, tha ai që i printe kolonës dhe kërkoi nga nënë Ajkuna që t'iu tregonte udhën për t'ia zënë tē gjallë djemtë. Ju nuk mund ta zini as

Liridonin, ju nuk mund ta zini as Trimin, ju nuk mund ta zini as djalin tim të madh, ju kurrë nuk mund ta zini Zjarrin e Diellit tonë. Po e zutë Zjarrin e Diellit tonë, i kapni edhe djemtë e mi.

- Ti edhe thur çarapë edhe filozofon, ku i ke djemtë, se të erdhi vdekja?!

Nënë Ajkuna e preku vetullën e majtë, aty kishte një bengzë, flokët e bardha ia kishin mbuluar bengzën. Kur ishte nuse vajzat dhe nuset e tjera pandehnin se bengzën vetë e kishte vënë. Ia shtonte hijeshinë në nusëri, në pleqëri puçej me flokun e bardhë. Ne kemi pushtet në këtë tokë, e jo ti që bën sehir me flokun e bardhë dhe hesht, ku i ke djemtë po të flasim për herë të fundit. Për herë të fundit u dëgjoftë zëri juaj në tokën tonë, mallkoi në heshtje nënë Ajkuna, u ul prapë nën strehë të shtëpisë, hyri prapë brenda, njerëzit e Pitonit dhe kukudhi me gungë të zezë i çanin muret e shtëpisë, po kërkojmë libra të Tiranës, thanë ata, dhe qeshën ha, ha, ha! A të hiqet gunga nga shpina nëse gjeni libra të Tiranës? Mos fol, plakë e gjorë, tha

njeriu me gungë të madhe në shpinë dhe e tregoi tytën e revolverit. Nëse nuk gjejmë libra, do të gjejmë armë, tha ai dhe qeshi prapë. Lëre që nuk e zumë Liridonin, lëre që nuk e zumë Trimin, lëre që nuk e zumë Gencin, vëllanë e tyre, por nuk po gjejmë as armë e as libra që i ka botuar Tirana. I keni fshehur në thellësi të tokës. Nuk i kemi fshehur në thellësi të tokës por në thellësi të shpirtit, tha nënë Ajkuna.

## (PËLLUMBI I PLAGOSUR)

Të gjithë njerëzit që ishin banorë të lagjes Kodra e Diellit në Prishtinë për një kohë harruan se janë banorë të saj. Disa u penduan pse janë banorë të saj. Ata që u penduan e shihnin edhe më afër vdekjen seç ishte në të vërtetë. Vdekja iu trokiste të gjithëve mbi kokë. Ata që e kishin rrethuar këtë lagje ishin përbetuar se do t'ia ndërronin edhe emrin, se nuk do të quhej më Kodër e Diellit, as Kodër e Hënës, por Kodër e Varrimit të të gjithë atyre që ia kthejnë fjalën Pitonit dhe kukudhit me gungë të zezë në shpinë. Qyqarët ua vënë dritareve perdet e natës, nata e Karpatave kishte hyrë që moti në dhomat e tyre. Pitoni me yllin e kuq në ballë dhe me thikën në dorë ishte përbetuar

në kokë të djalit të vet, oficer i lartë në Beograd, që t'ua nxirrte me thikë zemrat Liridonit dhe Trimit, atyre që ishin fshehur në bodrume të Kodrës së Diellit për t'i ikur mordjes që i ndiqte. Ata kishin thënë se Kodra e Diellit nuk ka liri, siç nuk ka liri as Kosova, por liri do të ketë tërë toka jonë kur shkëputet hapi i valles së përbashkët i Pitonit të Karpatave dhe kukudhit me gungë.

Kukudhi e shikoi në sy Pitonin, që të dy urdhëruan që të vriten ose të kapen të gjallë djemtë e nënë Ajkunës. Kur i shtohet gjëma lagjes Gjëmëmadhe jo vetëm që na rritet neve nami, tha Pitoni, por edhe na shtohet lumturia. Mbi fatkeqësinë e këtyre të të krisurëve bëjmë lumturinë tonë, tha dhe qeshi kryekukudhi. Ti përfundimisht ke he-qur dorë nga rrënja jote, i tha kryekukudhit Pitoni dhe i ndezi një cigare që e mbante në gojë. Është një nder i madh që ma bëtë, tha kryekukudhi, dhe iu dridh buza, tymi i duhanit ia turbulloi edhe më shumë sytë. Në një nga bodrumet e Kodrës së Diellit kemi vrarë dy shqiptarë që nuk i gjëzoheshin ardhjes sonë në Kosovë, por e mallkonin këtë ardhje

e harronin se para se tē vijmë ne, kishte ardhur nē Kosovë i shenjti ynë, kishte ndërtuar kisha dhe manastire. Shqiptarët ishin ata, thoshin ata që i vranë, që i ruajtën kishat dhe manastiret sllave, se kemi kodin tonë tē maleve që e trashëguam nga Leka. Leka na ka mësuar që tē mos i rroposim kishat dhe manastiret edhe kur ato janë tē huaja. Këtë virtyt tē shqiptarëve e shfrytëzuam për qëllime tona, siç i shfrytëzuam edhe fishekët që i ka prodhuar Kragujevci. Do t'i vrasim edhe djemtë, e Ajkunës, tha kryekukudhi dhe fshiu sytë me një faculetë tē bardhë, por prapë sytë e tij kishin xëc. Iu mjegulluan sytë edhe Pitonit me mjekrën hark.

- Të gjithë pas tyre! - urdhëroi Pitoni. Policët e veshur me rroba tē kaltra, ushtarët me rroba laramane dhe hetuesit me rroba tē ndryshme u shpërndanë si gjarpërinxhët nëpër Prishtinë. Një vijë ujë nē lagjen Velania, por e zhurmshme, ua pret udhën djemve tē nënë Ajkunës. Ata e kapërcejnë vijën e ujit, zhurma mbetet prapa. Dolën nē lagjen e plepave. Nën kubenë e madhe tē një shtëpie kishte qëlluar e hapur një derë e hekurt.

- Të hymë në këtë shtëpi, - tha Liridoni.  
Ata u bënë një me strehën e shtëpisë.  
Shtëpia dukej në fillim e shkretë, por ajo nuk  
kishte qenë e tillë: në një dhomë të saj dukej  
një dritë. Hëna ishte e venitur, shpesh e  
mbulonin retë. Ishin re të holla, por e mbu-  
lonin. Kurrë hëna s'kishte qenë më e venitur.  
E kishte trupin e plotë, por retë e holla prapë  
përplaseshin mbi të. Do të ndërroj moti, tha  
Liridoni. T'u kujtuan fjalët e babait, tha Tri-  
mi dhe mbështeti edhe më shumë trupin pér  
muri. Në dhomën me dritë, tha Liridoni,  
duket një njeri. Paska flokë të gjata, tha Tri-  
mi, mbi suprinë të tavolinës së tij po shoh  
shumë libra. Hëna e venitur kishte sy pér të  
parë lëvizjet e atyre që i ndiqnin Liridonin  
dhe Trimin. Ajo shihte edhe një mori qensh  
që shkonin herë pas, herë para policëve. Nuk  
dihej se kush printe në këtë ndjekje. Plepat  
ishin shtrirë si një hije e gjatë mbi çatinë e  
shtëpisë me derë të hekurt. Një erë e lehtë i  
prekte perdet e dhomës me dritë. Dhomat e  
tjera ishin të errësuara. Njeriu që lexonte në  
këtë natë ishte gazetar i "Rilindjes". Suprina  
e tavolinës së tij ishte e mbushur me libra të

botuara në Vjenë dhe në Paris. Kishte edhe libra të Tiranës, kapakët e të cilave ua kishte ndërruar, i kishte mbështjellë me kapakë të librave të shteteve të huaja. Një pëllumb u shkëput nga degët e plepit. Pak më parë u dëgjua një ushëtimë armësh. Pëllumbi e përgjakut një pjesë të xhamit të dritares. Ai e kishte parë dritën e ndezur në dhomë. Pëllumbi u mbështet në parmak të dritares, gjëmonte. Sado që gjëma e tij ishte e vockël, njeriu që lexonte në këtë natë e dëgjoi. E mbylli me rrëmbim librin: "Në luginen e Siera Altës" të Maria Alise Baroza dhe iu afrua pëllumbit. E hapi dritaren, pëllumbin e vuri mbi libër. Pahetueshëm pëllumbi e mbuloi titullin e librit, por në këtë natë po hapej një libër tjeter: Liridoni dhe Trimi edhe më shumë iu kishin ngjeshur murit, ata edhe e kishin parë pëllumbin që kishte rënë nga dega, secili në mënyrën e vet shikonte edhe vdekjen e vet. Njeriu që donte ta shpëtonte pëllumbin dëgjoi frymëmarrjen e dy njerëzve. Doli nga dhoma, le të më qëllojnë edhe mua, tha ai, dhe eci drejt strehës së shtëpisë. Jeni të plagosur?! pyeti

ai me trishtim, i njohu që të dy, vrapoi për të mbyllur derën e hekurt, tre veta shikonin një pëllumb që kishte derdhur edhe pak gjak mbi libër. Ne u shpëtuam plumbave, tha Liridoni, por si ta shpëtojmë pëllumbin. Trimi preu një pjesë të këmishës së vet, ia lidhi këmbën pëllumbit. Ai u struk në shtrate ngriti pakëz kokën, sikur donte të tregonte se do të shpëtojë... Ikëm nga vdekja, o Gani Lubeniqi, por nuk pandehnim se shtëpia ku banon ti do t'ia rrembejë vdekjes shpatën. Rastësia është vetë mbretëri, unë hapa dritaren për ta shpëtuar pëllumbin e shpëtova Liridonin dhe Trimin.

Hëna e venitur, megjithatë, kishte më shumë dritë se qiriu që digjej pranë librave të Gani Lubeniqit. Qiriu ishte ngulur në një filxhan, flaka e tij krijonte figura të çuditshme edhe në muri. Lagjja ku banonte Gani Lubeniqi ishte pa dritë elektrike.

Sytë e Liridonit herë drejtoheshin nga pëllumbi, herë nga një libër që kishte një ballinë të çuditshme. Në atë ballinë dukej si po e kafshonte diellin kulçedra. Të çuditshëm janë këta piktorët tanë, disa prej tyre

edhe të sëmurë shpirtërisht janë, po si është e mundur që kulçedra ta kafshojë diellin, lemeritës duhet të jetë edhe libri. Mos u nxito, Liridon, ballina e këtij libri fsheh të kundërtën: para rrezeve të diellit shkrihet çdo kulçedër. Këtë libër e ka botuar Tirana. Bën fjalë për prejardhjen tonë. LIBRI tregon se ilirët dikur e sundonin tërë bregdetin e Adriatikut, e tash sllavët na e kanë marrë edhe Ulqinin. Ka ikur ajka e kombit përtejt deti, kur vdiq Skënderbeu iku ajka jonë. Ajo do të kthehet, tha Trimi dhe pyeti:

- Po ballina?

Ballina e librit, sqaroi Gani Lubeniqi, është marrë nga një libër i huaj për të mbuluar kështu të bukurën me të shëmtuarën, mos të ma hetojnë kukudhët. Po kukudhët kanë filluar edhe të heqin dorë nga gjuha letrare shqipe. Ata sikur gëzohen edhe më shumë kur arrijnë të flasin në gjuhën e mëhallës që i ka rritur dhe përdorin fjalë të huaja sllave dhe turke. Një kukudh i tillë qëlloi një ditë me shkumës shkronjën Ë. S'na duhet kjo shkronjë, tha ai, e shikoi Dushanin në sy, ai ia mbylli prapë syrin, do të thotë i

dha urdhër të fshehtë që t'i godasë edhe tridhjetë e pesë shkronja të tjera.

-Qëllojnë shkronjat tonë, - tha Trimi.

-Shigjetojnë sytë tanë, - tha Liridoni.

Gani Lubeniqi iu afroa pëllumbit të plagosur, e përkëdheli në gushë, e afroi pranë zemrës, e përkëdheli prapë, iu duk se po e hapte edhe syrin e majtë. Dhomë ishte e ngrrohtë. Liridoni hapi dritaren, por e mbylli prapë me rrëmbim. Ajri i ftohtë i natës hyri në dhomë duke i gufuar perdet. Perdet u qetësuan, por Liridonit iu shtua shqetësimi. Ata që kanë ardhur nga Karpatet, tha Liridoni, do ta ndienin dridhjen e dheut tonë në këmbët e tyre me gishtérinj të mëdhenj, por qëlluan servilët dhe kameleonët politikë që hynë në valle me ta, kësaj valleje duhet t'i dridhet dhei nën këmbë. Mjaft duruam robërinë! - ngriti zérin Trimi, por Gani Lubeniqi me të drejtë kërkoi që të ketë qetësi. Nata i shton kukudhët, tha ai, dhe shikoi prapë në dritare.

Një flutur e bardhë kishte hyrë pa hetueshëm në dhomë. Flutura e kishte formën e zemrës. Ajo sillej rrëth qiriut, por e donte

zemrën e vet. Ishte e kujdeshme që të mos i prek krahët në atë flakë tepër të vockël, ngase mund të ishë vdekjeprurëse për një flutur në formë të zemrës.

Ndjekësit e Liridonit dhe të Trimit e merrnin në lidhje telefonike Pejën, Deçanin dhe Gjakovën. Nëse i zini të gjallë, urdhëronte Pitoni i Karpateve, lidhni dhe të lidhur pushkatoni në kufi. Pastaj, ngriti zërin kryekukudhi, do t'ia dërgojmë një notë të rrebtë Tiranës dhe do t'i themi se ushtarët tuej kanë vrarë dy qytetarë tanë. Dy qytetarë tanë, foli me cinizëm Pitoni dhe ndezi edhe më shumë dritën e baterisë. Xhipi i tij u nis drejt lagjes ku është një fabrikë e moçme e tjegullave. Në atë lagje ka vetëm shqiptarë, tha ai, atje do të jenë fshehur Liridoni dhe Trimi, tha, ndezi një cigare dhe ofshani prapë. Nata e venitur ishte fshehur pas Bjeshkëve të Nemuna. Terri ishte bërë më i dendur në Prishtinë, por agimi nuk ishte larg. Liridoni dhe Trimi i thanë Gani Lubeniqit se duhet të largohen nga shtëpia ku banonte ai para se të lindë dielli.

Liridoni veshi një xhamadan të Gani Lubeniqit ndërsa Trimi një këmishë të tij.

Pëllumbi i plagosur shikonte si shtrëngoheshin tri palë duar. Të dy vëllezërit u futën nën degët e një bliri, zhurma e hekurave të derës nuk u dëgjua fare. Gani Lubeniqi iu kthyesh pëllumbit të plagosur, ai po e lëvizte kokën, ishte shenjë e mirë se ai edhe pakëz e do t'i lëvizë edhe krahët. E priste qelli pëllumbin e plagosur, por cila udhë i priste dy vëllezërit nuk e dinte as nëna e tyre...

## (UDHËT TONA COJNË TE NJË PIKË)

Lopatat pllparisin shurdhër, dëgjohet kërcitja e dhogave të barkës që fërkohet pas gurëve të bregut. Tuna rrjedh tatëpjetë e heshtur, por e shqetësuar. Shqetësimi i madh përherë është në heshtje të thellë. Ndihet një erë e fortë balte e bimësh të kalbura. Në të majtë shquhet mulliri i Sundimtarit, ndërsa në të djathtë shtrihen pambarim livadhe qershish dhe vishnjash panonike. Qielli është gjelbërosh, ia ka marrë edhe yjtë e Tunës. Ndoshta Tuna i ka marrë yjtë e qiellit. S'ka rëndësi: një huazim i ndërsjellë që lidh ujin dhe qiellin. Yjtë nuk mbisin vetëm në suprinë të lumiit, ata thërmohen dhe radhiten mbi dhe brenda tij.

- Kush është atje, Liridon?

- Unë! - vjen një zë që duket se doli nga lumi, por ai dilte edhe nga qielli. Liridoni kërceu nga barka. Edhe dy vëllezërit e tij i priste bregu. Natën kishte rënë shi, toka derdhej në lumë.

- Ka ardhur komandanti i garnizonit?

- Po çuditemi pse vonohet.

- Ushtarët ia ngatërrojnë hapat komandanit.

Një hije iu del përpëra që të treve. Hija nuk ishte më hije: para tyre ishin pesë kuaj. Ishte vjeshtë e vitit 1978. Pesë kalorës mbanin të shtrënguar pesë frerë. Larg, ku është fundi i livadheve, duken ca suka mavi, që mbyllin horizontin dhe ngjajnë si pirgje të vogla. Ishin shtëpitë e atyre që rrojnë përtej Tune. Pitoni me mjekrën hark kishte edhe më shumë robër. Të tjerët ishin këndeje Tunë. Te kthesa e madhe, atje ku fillon pylli me selvi, që shtrihet i dendur deri në qytetin S.M. duket një karrocë e rrëthuar nga kalorësit. Njëri nga kalorësit shkëputet nga kolona. Vrapon fluturimthi drejt Liridonit.

- Liridon!

Të dy vëllezërët e Liridonit shikojnë me duar strehë mbi sy. Liridoni dhe Visari i shtrëngojnë dorën shoqi-shoit. Kuajt e ledhatojnë tokën para këmbëve, edhe ata e dinë se kur duhet të gërryhet toka. Kuajt e hetojnë gëzimin dhe hidhërimin e kalorësve. Liridoni e preku në zverk kalin e vet, ai i bashkoi dy këmbët e para, kështu vepruan edhe kuajt e tjerë. Kur njeriu ik nga robëria, - nisi të flasë Liridoni, - në ujë gjenden barkat, në tokë - kuajt. Ushtarët flinin në kazermë, ne e shpifnim gëzimin, ata që shtiheshin se janë në gjumë pandehnin se ne jemi të lumtur. Sa vështirë e ka njeriu kur është i pikëlluar dhe e shpif gëzimin. Kështu tha Erëmali, Arsimi tha se derisa të ketë Piton në tokën tonë dhe kukudhë që ia puthin dorën, gëzimi ynë është një xëc që mbulon pikëllimin. Edhe në Vojvodinë po e urrenin Pitonin, por ishte tepër e heshtur ajo urrejtje. Ajo urrejtje po përnga jante në syltin që është në prak të bulbërisë, por ngricat e venitin.

Pse të flasim për Vojvodinë, - tha kalarësi që rrinte përballë Liridonit, edhe ne përngjajmë në sythin që s'e sheh bulbërinë. Të gjithë ne që jemi ushtarë të ushtrisë së huaj kemi ngricën tonë brenda shpirtit tonë. Pandeh ti se do të kishim dalë të gjallë po mos të ishte një sekret që s'e di ti, as unë nuk e dia deri sonte. Ma thuaj, Liridon! Ai komandanti i togut tonë që flet në gjuhë të Sundimtarit T. dhe ne pandehim se shkrihet për të, ai është i fisit tonë. Shqiptar është? Ai na ka hetuar kur e rrëmbyem karrocën, ktheu kokën në anën e majtë u shti se nuk po na shihte. Ai e dinte se kishte shumë ushtarë që njërin sy nuk e kishin mbyllë as në kët natë. Herë-herë gjuha e huaj është si rroba e huaj, por me rroba të huaja ne shpesh kemi mbuluar edhe trupin tonë të shëndoshë. Këtë ma tha edhe Liridoni, ushtari R. S. nga Kastrioti i Drenicës e lëvizi kokën, u gjëzua. Po ç'ishte një zë i një plakushi? Ishte plakushi Stanko, që merrte para nga Sundimtari, ushtarët shkonin natën në shtëpinë e tij, harronin depot me armë... Depot me armë?

Po, se hapnin depo të tjera. Nuk po të kuptoj. Ushtarët tërë natën flejnë me tri vajzat e plakushit Stanko, ai pi raki, vajza e madhe e mbulon me batanije. Kthehet prapë te ushtari që rri i shtrirë... Kjo ushtria e Sundimtarit me vajza ka fituar shtetin dhe me vajza do ta humbë. Kështu ishte edhe në kohën e Sulltanit. Sulltani vuri gishtin në tapinë e Ballkanit dhe u zotua në kokë të Milicës që tërë Ballkani të mbetet në duar të serbëve me kusht që Milica mos t'i ndërrojë burrat. Milica kurrë nuk u largua nga shtrati i Sulltanit, një ditë vdiqën që të dy.

Ata prapë bisedonin, por tash prapa kalorësve ngrihej ngapak pluhur. Karroca, duke u kolovitur, zvarritej më tutje e shqëruar nga renkimet e ushtarëve. Ushtari Visari iu afrua Liridonit, i tregoi se dje është njobur me ushtarin shqiptar nga Bujanoci, ishte ushtar që dinte mirë matematikën, kishte njoburi për filozofët më të mëdhenj të botës, për të dalë fitimtarë, tha ai, duhet të ikim nga koha e përgjumur. Koha e përgjumur i përngjan vdekjes. Në kohën e kralit

nuk ishte koha e përgjumur, por krahët tanë u shkëputen edhe nga shigjetat që vinin nga kancelaritë e huaja, përtej Ballkani. Kjo koha e Sudimtarit të kuq e ka përgjumur njeriun tonë, unë e shoh shpesh edhe nën çarçaf të bardhë. Nuk është përgjumur vetëm një njeri, por është përgjumur tërë një popull, apo shtihet se është përgjumur, ngriti zërin Liridoni, e fsheh urrejtjen dhe mallkimin ndaj Sundimtarit të kuq. Diellori nganjëherë i ngatërron këto çështje. Populli është si ara e mbjellë me grurë, po nuk pati shi gruri nuk mbihet, thahet në ulli, fatkeqësia i vjen pastaj. Shiu i arës është si gjaku i popullit, gjaku nganjëherë duket se është ngrirë, na duhet zgjimi nga përgjumja e përgjithshme. Unë nuk mund ta zgjoj popullin, tha Visari dhe kërceu nga kali, hoqi nga udha një trinë, një trinë tjetër kishte zënë derickën e kasollës. U hap edhe kasolla. Nën dritën e hënës u hap një arkë e vogël, doli një rrip i murrmë bezi dhe një copë tokë. Ja, vetëm kaq më ka mbetur, - tha Visari dhe e shikoi në sy Liridonin, foli prapë: Unë nuk

mund tē duroj dhe tē pres derisa tē zgjohet populli. Ku e di unë, ndoshta populli është nē një ëndërr, Sundimtari i kuq ka një fuqi magjike. Fuqia e tij është që edhe robi tē thotë se jam i lirë. Kështu ma tha edhe ushtari Sh. D.

Diellori i afrohet prapë Visarit. Në dritë tē hënës shikon ai rrypin prej bezi. Zemra i ndrydhet. Po mirë, - tha Liridoni, kjo qenka një copë nga sharpa që i solla unë dhuratë Artës, motrës sate. Motra ime do tē ishte nusja jote, por hapat m'u ngatërruan kur më burgosën nē Pejë. Unë isha nē burg, por lajmi i zi hyri edhe nē qelinë time: ma kishin vrarë vëllan, motra kishte thënë se nuk do t'i bëhem nuse askujt nē këtë botë, korbë jam prej sotit. Nga pikëllimi i madh më vdiq edhe motra, na u dogj shtëpia, nga shkrumbi i shtëpisë është ky dhe. Qyshku i Pejës kurre s'kishte parë flakë më tē madhe. Kukudhët na e kishin djegur shtëpinë dhe tē parët kishin vrapiuar nē Pejë pér tē lajmëruar se telat elektrikë ishin fajtorë. Edhe gazeta shkroi pér ata tela dhe nuk e përmendi fare udhën e kukudhëve.

Ata ia kthyen shpinën kasollës, ecnin përtej Tune.

Secili mendonte në mënyrën e vet, por të gjithë bashkoheshin te një pikë... Ajo ishte e largët, herët a vonë do të arrijnë. Ata iknin nga një ushtri e huaj dhe vraponin në tokën e të parëve të tyre që tash ishte bërë e huaj. Çdo gjë ishte e huaj, jo vetëm rrrobat që i kishin veshur. Vetëm ata i takonin dheut që e ruanin në fshehtësi të madhe.

## **(DORDOLECIN E KUQ E GJUANIN ME GURË FËMIJËT)**

Zëri "Ndal!" sa ishte qortues, po aq ishte urdhërues. Kolona e kalorësve u ndal. Nga qielli binin flokë të mëdha dhe të rënda bore, si flutura të ngrira duke u kolovitur me përtesë. Disa flutura të bardha shkriheshin pa rënë në tokë.

- Erdhi Liridoni? - pyeti një zë.

Edhe nata po shkrihej në ditë. Mbi gu-nat e kalorësve bora po pikture flutura të bardha. Jeta e tyre nuk ishte e gjatë, binin flutura të tjera të bardha. Sa i madh është qielli, tha Liridoni, më duket se është i madh sa dëshira e nënës sime që të më jap prapë qumësht të vluar. Zërit që pyeti për Liri-donin iu përgjigjen ushtarët që kishin ikur

nga ushtria e huaj: Unë jam nga Kastrioti i Drenicës... Unë jam nga Qyshku i Pejës... Unë jam nga Kaçaniku... Unë jam nga Bujanoci... Unë jam nga Ulqini... Tërë SHQIPËRIA e pushtuar paska ikur nga ushtria e huaj. Po si iku pahetueshëm Liridoni? Ishte në krye të kolonës, tash s'është fare. Ka hyrë në shtëpinë e një slloveni. Sa e do Liridonin Franc Leshniku. Dy herë i ka thënë: "Liridon, ne sllovenët të parët do të ndahemi nga shteti i Sundimtarit të kuq, për të krijuar shtetin tonë..." "Liridoni i tha atij tri herë: "Kosova e para e nisi luftën për t'i ikur syve të Sundimtarit të kuq, por të gjithë heshtën... Heshte edhe ti, Franc Leshnik..." "Po Sundimtari i kuq i kishte në duar edhe gazetat, o Liridon"...

- Po ti kush je që zërin ta dëgjojmë, emrin nuk ta dimë?

- Emrin ma di Liridoni.

- Iku Liridoni bashkë me emrin tënd?

Zëri që ishte ende i panjohur për kalarësit e zemëruar u bë i njohur:

◦ - Viktor Damiri jam. Edhe hapat e mi ikin nga Sundimtari i kuq. Ikja e njëjtë na ka

bashkuar me shqiptarët. Kalorësit e zemëruar derdhën zemërimin para këmbëve të kuajve. Ata nuk e gjerryenin më tokën. Ushtari Sh. D. thirri i gëzueshëm. Ai i pari kishte parë Liridonin. Po kthehej i gëzuar hipur në kali. Kur koka e kolonës është e gëzuar, gëzohet edhe trupi i saj, gëzohet edhe bishti i saj, ngriti zërin Visari, por u qortua pse kolona të ketë bisht. Kolona jonë ka kokë dhe trup, tha ai, e nuk ka bisht.

I veshur me një pallto të gjatë ngjyrë gri, me një kaçullë të lartë ngjyrë kafeje prej lëkure të qengjit që ia kishte mbuluar kokën, por jo edhe sytë, i shoqëruar nga dy ushtarë që kishin një emër të përbashkët - Rudolf, Liridoni çau kaluar kolonën e heshtur. Ajo tash valëvitej si tallazet e detit, bora u bë më e ftohtë dhe më e dendur, zërat gjëmuani:

- Liridoni...
- Liridoni...
- Liridoni...
- Liridoni...
- Liridoni...

Liridoni e shtrëngonte frerin e kalit, eci përpara gjer në një sukë, pranë saj ishte një

barrakë e braktisur dykatëshe. E la prapa barrakën, iu afrua kolonës, nxori nga xhepi një letër, para se ta lexonte tha se përmbyssja e Sundimtarit të kuq nuk i takon vetëm Kosovës, edhe Shlossenë i takon. Shqiptarët dhe sllovenët do të jenë miq, i kemi bjeshkët e larta, me teleferik do t'i lidhim, do ta bëjmë edhe më të fortë miqësinë se telin e çeliktë të teleferikut. E ç'miqësi është ajo nëse nuk është më e fortë se çdo metal. Dikujt kjo mund t'i duket romantike, por as jeta nuk e ka kuptimin e vet nëse i mungon tërësisht romantika.

Liridoni e shikoi edhe njëherë letrën, por iu duk se edhe vet po bëhet sundimtar nëse nuk e flet. Ai e futi letrën në xhep dhe nisi të flasë:

- Asnjë ligj në botë nuk mund ta ndalojë njeriun që t'i bëjë ballë së keqes. Gjyshi im, ndjesë pastë, por edhe gjyshi i dy Rudolfave që i kam pranë, kanë thënë se po të dalë përpara gjarpëri dhe ta zë udhën, ai nuk ka dalë për të vallëzuar dhe për të të bërë ty të gëzuar, por për të të kafshuar, andaj mos e lë që të bëjë sehir, por qëlloje në kokë. Sun-

dimitari i kuq e ka dërguar në Kosovë, siç e ka dërguar edhe në Slloveni, gjarpërin me njëqind koka dhe njëqind gojë, deri kur do të mbesim kafshatë e tij!!! Nuk çuditën vetëm njerëzit në heshtjen tonë, por edhe kodrat tona, edhe livadhet tona, edhe deti ynë, edhe lumenjtë tanë. Ndoshta edhe e mallkojnë heshtjen tonë. Toka po shungullon që nga thellësia. Këtij vendi, ku jemi tash, i thonë Jesenicë, edhe qelli mbi Ješenicë po derdh, lot, nuk është borë e bardhë kjo që po e shihni, lotët e bardhë të qiellit tonë janë. Pse u shpalos flamuri shqiptar në lagjen time Gjëmëmadhe, ra nga karrigia e butë edhe Sundimtari i kuq. U bë Shqipëri, - tha ai dhe u ul në fronin e vet. Unë kam ndërmend ta hedh Shqipërinë në det, tha Sundimtari i kuq, e një lagje me emrin e çuditshëm shpalos flamurin e saj, gati sa nuk më ra pika nga pikëllimi, tha dy herë Sundimtari i kuq.

- Sllovenia është republikë, por më parë është Jugosllavi, andaj është republikë e vdekur, - tha Viktori. Sllovenia do të rilindë kur të vdesë më parë Jugosllavia. Ajo s'mund

të jetojë më në tokën tonë, nëse ka diku tokë të vet, le të rrojë në të, jo mbi tokën tonë, ngriti zërin Rudolfi i parë, Rudolfi i dytë e lëvizi kokën.

Çeta e kalorësve ishte edhe më e gjatë, në krye të saj ishte Liridoni dhe Viktori. Viktori fliste diçka në heshtje, Liridoni diku thellë në male shikonte kitarën që e kishte lënë në Kodër të Diellit, në Prishtinë. Ai e shihte tërë Prishtinën në një pikë të malit që e kishte përpara, e brenda asaj pike ishte prapë kitarja e tij, që nxirrte një zë të heshtur: Ç'tmerr prej kreshtës së Veleçikut endet poshtë në kep të Shtyllit, për inat të djallit e t'armikur, sot është shkruar në libër t'qiellit... Edhe flamuri i Shqipërisë, si flakninë e Perëndisë, do t'valvitet në Kaçanik. Në Kaçanik po do t'valvitet kuqezi flamur shqiptari, sepse toka shqip ku flitet është jona prej si parit. Trashëgim ne kemi pasë, kombi i huaj s'ka pse të shklasë...

Liridoni e kishte edhe më pranë kitarën e vet, e përtej saj një plak me pelerinë të bardhë ecte me hapa më të mëdhenj se bjeshtë. Liridoni e shikoi prapë kitarën e vet e

brenda telave të saj shihte Gjergj Fishtën. Ai e kishte zemrën e pikëlluar, zërin ia kishte ndalë Sundimtari i kuq...

Në atë bjeshkë ai shihte turrin e milicëve, zërin burbuje në Kodër të Diellit. Largësia midis milicëve të Sundimtarit të kuq dhe dy djemve që kishin hyrë në bodrum po shkurtohej. Cerberët kishin më shumë armë, e zemër s'kishin.

Gjaku i Ilirit dhe i Drenit kishte skuqur bodrumet. Ata i nxorën të vrarë, edhe të vdekur qëlluan me predha kukudhët. Liridoni e shihte prapë kitarën e vet, ajo vajtonte, por edhe përbetohej në sythin e pranverës që do të vijë. Një puhi e ngrohtë i shkriu prapë fluturat e bardha, çeta u ndal për të pushuar. Jesenica kurrë nuk kishte parë njerëz kaq të pikëlluar, por edhe të vendosur që të ndërtohet teleferiku... Fëmijët e lagjes më të vjetër të qytetit kishin bëre nga bora një dordolec, e qëllonin në kokë me gurë, është Sundimtari i kuq, thoshin ata. Edhe dielli që shpërtheu një re të zezë nis ta shkrinte dordolecin... Çeta ecte me hapa të matur...

## **(ZËRI I KITARËS NUK KISHTE PUSHUAR)**

Ai ishte një kalorës që ikte nga endej Sundimtari i kuq, por përtej malit nuk shihe vetëm kitarën, nuk shihe vetëm Gjergj Fishtën... Ai shihe atje Fushën e Thatë, të mbushur me kalorës të tjerë. Përtej kalorësve ishte ushtria e imagjinuar me topa dhe raketa të drejtuara nga Sundimtari i kuq. Tutje ishin ushtarët përgjues, të cilët e dinin edhe hapin e milingonës. Në qìell fluturonin avionët e luftës, ktheheshin mbi det, vinin prapë, por asnjëri prej tyre nuk hidhte raketë mbi Sundimtarin e kuq. Përtej një lisi të moçëm ai shihe mësuesin Petrit Shkaba, i cili trokiste në derë të kullës, dera hapej

ngadalthi. Mësuesi Petrit Shkaba e shikonte Liridonin me dashuri të thellë. Vetëm mësuesi ka dashuri të tillë ndaj nxënësit të vet. Në sytë e mësuesit hyri një shqetësim, hetohej edhe në ballin e tij. Kanë hyrë në vrimë të miut të gjithë servilët dhe ata që i gjuanin shkronjat e alfabetit tonë, i tha Liridoni mësuesit të vet, por prapë lirida-shësit në Prishtinë do të zgjohen. Ata nuk pajtohen që të mbetet i përgjumur populli ynë. Lajme edhe me të mira kemi nga Tirana. TIRANA ishte ajo që i solli mësuesit e parë në Kosovë, Tirana ishte ajo që i solli abetaret e para në Kosovë, Tirana ishte ajo që i mësoi shkrimtarët e Kosovës si të shkruajnë libra... More Liridon, të gjitha këto fjalë unë t'i kam mësuar, e ti tash po më bind se nuk i ke harruar. S'e pata këtë qëllim. Po ti që vetë po shkruan libra, ke dëgjuar, apo nuk ke dëgjuar se si disa shkrimtarë të Kosovës flasin me përbuzje për Tiranën. Njëri prej tyre ishte një ditë në Tiranë, kur doli në shkallë të hotelit "Dajti" i drejtoi sytë nga Gërmia... Andej është deti, i thanë, po unë Gërminë po e kërkoj. Je ende i

përgjumur. Mund të jetë gruaja ime e përgjumur, dua të kthehem prapë në hotel, t'ia nxjerri gjumin gruas sime, është sot e diele, fëmijët e mi duhet të dalin në Gërmë, sa mirë e drejton veturën gruaja ime. Ke veturë personale? Një e ka gruaja, një tjeter unë, do t'ia blejmë edhe vajzës, pastaj edhe djalit, por ai ende është i ri. Motra e gruas simë punon në Komitet, në shtëpi të saj kanë katër vutura, ajo ka edhe dy vila. Je ti shkrimtar i Kosovës, apo na ke ardhur nga një planet tjeter? Nga Kosova jam. Ne e dimë se Kosova është e robëruar nga Sundimtari i kuq. Unë kurrë më shumë liri se tash nuk kam pasur. Ka liri edhe motra e gruas sate? Ajo ka edhe më shumë. Del shpesh në Gërmë? Shpesh shkon edhe në Brezovicë, të gjitha banjot e Serbisë i njeh ajo. E njeh edhe atë banjon që i detyron femrat të lindin edhe kur mjekët kanë konstatuar shterpësinë e tyre. Kishte hyrë një ditë një gjarpër në Komitet, e kishte kafshuar në vithe motrën e gruas sime, do të ngelte pa fëmijë po mos të ishte Matarushka Banja. Gjarpëri kishte hyrë në Komitet?!!! Po, po kishte hyrë. Tirana ka dëgjuar për

këtë, por ti pse e ule kokën. Më lodhe duke e shikuar diellin. Në diell nuk është Gërmia. Nuk është, de. Gjarpëri e kishte kafshuar motrën e gruas sime në Gërmni, se në orar të punës kishte quar dashuri me shefin e Partisë. Hataja do të bëhej po të mos përhapej fjala se gjarpëri e ka kafshuar në Komitet.

Unë, tha shkrimtari që shikonte Gërmninë në diell, kurrë më nuk do ta gënjej Tiranën. Sa shpejt i qet në shesh gënjeshtarët, pse mos ta them. Unë vetë e kam vjedhur një ide të një shkrimtari tiranas, desha të shkruaj në gazeta të Kosovës se ai ka vjedhur nga unë, por u ngrit në qiell kali dhe tregoi se rreth kështjellës kam gërryer tokën së pari në romanin e botuar në Tiranë. Reagoi kali, e po të reagonte njeriu, unë do të çmendesha. Këtë ma tha në sy edhe Skënder T., Liridon, edhe Skënderi ishte nxënësi im, sa më ka marrë malli për të. Është përmalluar tërë Isniqi. Ai hyn në turmë të njerëzve në rrugë, në livadhe, në shkolla në kulla dhe tregon se Liridoni nuk është në Slloveni, mos e kërkoni as në

Kosovë, s'ka dalë në Shqipëri, siç flasin kukudhët, por është në Gjermani... Ishte më parë në Zvicër, pas i shkonin kukudhët, i kishin mprehur shpatat. Njerëzit e pyesin Skënderin se kurë do të kthehet në Kosovë Liridoni ynë. Ai e përmend shpesh prillin, ndoshta pse ky muaj ka shumë lule. Ku e di pse Skënderit i pëlqen shumë prilli. Prilli i pëlqen shumë edhe Kadri Pejës, Peja është përmalluar për të. Blerim Tomori iku nga sytë e mësuesit, iku edhe bjeshka nga sytë e Liridonit, Skënderi ecte drejt Prishtinës...

Ushtria e imagjinuar ia shtoi qiellet edhe njëqind avionë të luftës... Liridoni nuk i besonte imagjinatës, ai kishte vu duart në faqe, po bisedonte me Enver Pejn. Në sytë e tij dukej edhe kali që e kishte larguar nga një qytet kufitar i Sllovenisë. Kishte hipur në një tren të gjatë, e kishte përvendetur me pehatje dore kalin që vraponte pas trenit. Vraponte pas trenit në mes të dy binarëve, ndoshta të shkretin e ka shkelur treni që vinte i ngarkuar me qymyr. Shqiptarët, - nisi të flasë Enver Peja, kanë Lidhjen që nuk i përcan në parti e në krahina, në fise e në fe,

po i bashkon në shqiptarizëm, andaj tërë Mynihu do të ngritet sot në këmbë. Ta dëshiron kështu zemra, o Enver Peja, por tjetër është zemra, tjetër është demonstrata. Po dështuam, unë do t'ia kthej shpinën edhe Gjermanisë, ku të shkoj unë i gjori. Liridon, e sheh rrebeschin që po ecën drejt Urës së Madhe? Po e shoh: njerëzit tanë janë? Të gjithë. Edhe nga lumi po vijnë... po vijnë nga të gjitha anët. Të gjithë janë lodhur nga robëria, kush tha se populli ynë është në gjumë? Unë kam thënë njëqind herë, o Enver Peja. Ke dashur ta shohësh popullin kështu të zgjuar, ke dashur... populli të pret, po dëgjohet emri yt. E sheh: edhe qëlli ka më shumë sot kaltërsi, kemi pritur që do të dalin në Shesh nja një mijë demonstrues, por vetëm në drejtim të Urës së Madhe janë nja dhjetë mijë. Të gjithë shqiptarët kanë dëlë, askush nuk është më në gjumë. Sundimtarë i kuq ua ka rregulluar pasaportat që të ikin në Gjermani dhe mos të kthehen kurrrë më në Kosovë, por Kosova i ka djemtë e vet që më shumë e duan lirinë se tërë Gjermaninë. Po bie në lumë plani i Sundimtarit të kuq. Sot

po bie. Po bie edhe plani i kukudhëve, Enver Peja. Shih sa të kujdeshëm janë kalorësit gjermanë. Ua çajnë rrugën demonstruesve, e ruajnë Sheshin, mbajnë helmeta në kokë. E dinë këta se një ditë do të bjerë Muri i Berlinit dhe do të bashkohet Gjermania. Po ata me kamera që u futën në turmë? Ata nuk janë njerëzit tanë. Ata janë të dërguarit specialë të Sundimtarit të kuq. Do t'i dërgojnë fotografitë e demonstruesve në zyrat e tyre. Kanë shumë zyra sekrete. Por, tërë shteti i Sundimtarit të kuq është sekret: ende Evropa nuk di pse dhe si u formua ky shtet me Sundimtarin e kuq në krye. Së pari e bëri këtë shtet krali, me bekimin e Moskës, por edhe me përkëdheljet e Evropës. Mos të zgjasim, masa është drejtuar nga ti, Liridon. Masa është drejtuar nga Kosova, Enver Peja. Dëgjo, dëgjo: po jehojnë këmbanat e kishave të Mynihut. Tërë qyteti është me ne.

Optimizmi i tepruar shkakton entuziazëm të tepruar, - nisi të flasë Liridoni, - andaj duhet të ruhem i që të mos bëhem as optimistë të tepruar, as entuziastë të tepruar, por të jemi racionalë, dhe vetëm atëherë

hapat tanë nuk do të ngatërrohen. Enver Peja e dëgjonte me vëmendje Liridonin, në sytë e tij shihte qiellin mbi Pejë dhe një shall të bardhë që herë shndërrohej në re, herë merrte formën e një libri. Nga qelli pastaj binin shkronjat, një kukudh që kishte veshur rroba të kaltra shkonte dhe e shkelte shkronjën e parë, kukudhi tjetër kapërcente urën dhe nxitonte edhe më shumë për t'i shkelur dy shkronja të tjera. Shkronjat tona, fliste në heshtje Liridoni, janë më të shpejta se kukudhët; ato ngjiteshin prapë në qzell, bashkoheshin prapë me shkronja të tjera dhe një re e bardhë ecte drejt Manastirit. A-ja fliste se në Manastir është krijuar trupi im, tërë bota foli për zërin tim, edhe unë tërë botës i thashë se me mua nis të shkruhet emri ALBANIA. Reja e bardhë fluturonte paştaj drejt Tiranës, por Liridoni në qelli mbi Dubovik shikonte kitarën e vet, ajo ishte mbështetur në muri, e shikonte nëna e tij, e përkëdhelte, një zë vinte nga atje, Mynihu e dëgjonte: Liridon, Liridon...

Liridoni dhe Enver Peja ecnin drejt turmës së gëzuar të njerëzve. Pikëllimin de-

monstruesit e fshihnin me lulet e freskëta që i lëviznin në qielli. Të gjithë e dinin se Sundimtari i kuq mund t'i dërgojë pitonët e vet që t'ua prejë fëmijët në djepa, t'ua përplasë shamitë e bardha nënave të tyre të mërzitura, t'ua nxjerrë sytë nuseve që aq shumë ishin përmalluar për burrat e tyre kurbetçinj, t'ua këpusin hullinë baballarëve që e mbillnin grurin në ara, por një hulli edhe më e gjatë ishte hapur sot në Mynih...

Lulet prapë lëviznin në qiell, lulet nganjëherë janë mashtruese, një lule të kuqe kishte marrë edhe një kukudh, e pehatte në qiell, por shpejt iu rrëmbye nga dora. Ti edhe mbi sytë tuaj ke vënë maskën, i tha ai që e njihte, kukudhi deshi ta merrte lulen, por nuk pati kohë. Ai doli nga rreshti, e mbante dorën me të dyja duart dhe eci drejt zyrës sekrete të Sundimtarit të kuq, rreshti i njerëzve eci edhe më furishëm, dikush na i ngatërronte hapat, tha Drini. Drini edhe më furishëm e shtrëngoi flamurin shqiptar, ecte në krye të kolonës, kolona u ndal, u shpalosën edhe shumë parulla, të gjitha kërkonin që Kosova të shkëputet nga kthetrat e Sun-

dimtarit të kuq, të bashkohet me Shqipërinë, se Kosova është pjesë e saj. Një plakë gjermane që ishte mbështetur në parmak të dritares e shikonte flamurin shqiptar, i lexonte edhe parullat, ajo kishte qenë një antifashiste e dalluar, u kishte ndihmuar shqiptarëve edhe në Tiranë, ndonëse atëbotë kishte të veshura rrobat e një ushtrie që pushtonte, ajo edhe në spital, kur u plagos, tha se besim kam vetëm te mjekët shqiptarë, ata mund të ma nxjerrin plumbin nga këmba, ata më bëjnë që unë t'i kthehem prapë Gjermanisë. Po kur përfundoi Lufta e Dytë Botërore, Kosova duhej ta përfundonte robërinë, nuk qenka Kosova Shqipëri, u habit plaka Rozë dhe e mbylli dritaren, zbriti me ashensor, hyri në turmë, pas saj shkuan edhe dy vajzat e saj, turma u bë edhe më e madhe kur hynë në turmë edhe shumë plaka, edhe shumë vajza, edhe shumë djem.

Pranë Liridonit dolën shumë njerëz, të gjithë donin ta shihnin sa më afër Liridonin, turma bëhej edhe më e madhe, Kadri Rugova i tregonte Liridonit se në këtë turmë po e shoh edhe birin tim, Albanin, e mbi varrin

e-tij po shoh lule të freskëta. E vranë në burgun e Pejës katilat.

Vajza ime Drenushë e kishte emrin, nisi të flasë një plak tjetër dhe t'i tregojë Liridonit se nga është dhe kush është. Të njoh, mirë të njoh, të paçim, tha Liridoni, vajza jote doli ndër të parat në Shesh të Prishtinës, kërkoi që Kosova të bëhej e lirë, kukudhët ia lidhën duart, ty të thanë se vajza është arratisur përtej Bjeshkëve të Nemuna, se ajo e shkeli me këmbë flamurin tonë trengjëresh, se ajo... Vajza ime nuk e ka shkelur flamurin e askujt, por e ka bartur lart në quell flamurin tonë, e në tokë kush kishte pushtet. Kishit ju, o të gjorë. Ne të gjorë që mbajmë qetësi dhe i vrasim të gjitha vajzat që nuk klithin? "Sundimtari i kuq është shpëtimtari ynë!" Ajo nuk klithi, siç i thamë ne, por po klith ti tash për vajzën tënde, as varrin kurrë s'ke për t'ia gjetur. E keni hedhur në Dri? Nuk e kemi hedhur në Dri, por e kemi mbuluar me tokë të zezë. Toka e zezë do ta ketë një gjëmë të madhe, gjëma e madhe do ta nxjerrë mbi tokë vajzën time, gjëma e nadhe...

Kalorësia gjermane rrinte e qetë pranë plepave, policët e tjerë kishin dälë në krye të kolonave dhe drejtonin me fishkëllimë të pipave që i mbanin në gojë ku duhet të bashkohen të gjitha kolonat. Tërë sheshi u mbush me njerëz. Tash nuk dihej se kush është shqiptar e kush është gjerman. Për të parën herë kaq afër ishin dy popuj. Këmbanat e kishave edhe më shumë e shtuan zërin. Në qiell fluturuan pëllumbat e bardhë, të gjithë e mbanin nga një shirit të bardhë, ku shkruante se Kosova duhet të bëhet Shqipëri, ajo gjatë tërë jetës ka qenë Shqipëri, Sundimtari i kuq i ka rrëmbyer... Edhe më shumë bashkoheshin sot dy popuj, edhe më shumë sot bashkohej qielli me tokën. Atë çka e kërkonte toka, e kërkonte edhe qielli. Tokë e qiell u bënë një, edhe një fluturim i pëllumbave...

Pranë Liridonit u afruan edhe shumë gjermanë. Liridoni i njihte të gjithë, ishin parlamentarë, i kishte dërguar qeveria, i hidhnin lulet në drejtim të turmës, turma edhe më shumë gëzohej. Papandehur dikush klithi, një guri qëlloi së pari lulen që pehatej,

pastaj kokën e një demonstruesi, ishte kukudhi që u kthye nga zyra sekrete. Mos, të lutem, unë nuk kam dhembje fare. Po të të rrjedhë gjaku nëpër ballë, o Astrit. Mos, të lutem, unë nuk shkëputem nga turma, mos të lutem. Ti duhet të dalësh nga turma, drejt nesh është autoambulanca, duhet të shkosh te mjeku, të shkojë gjaku i téri. Dua t'ia dëgjoj zërin Liridonit. Unë do të të tregoj pér zërin e tij. Unë kitarën ia kam dëgjuar, zërin nuk ia kam dëgjuar kurrë. Edhe më shumë po të rrjedhë gjaku, këmisha ime nuk po mundet që ta ndalë gjakun, Astrit. Zëri i Liridonit ma ndal, unë nuk shkëputem nga turma...

Derisa po bisedonin Astriti dhe Ujkani një polic kishte rrokur pér flokësh kukudhin dhe po e têrhiqte nëpër trotuar, dera e veturës së policisë u hap, por nuk u hap fare dera e autoambulancës. Astriti ecte ngadal-thi, ai nuk hetonte se gjaku ia kishte mbuluar edhe këpucën e majtë, ai pahetueshëm u shtri në Shesh, Liridon! - klithi dhe i mbylli sytë. Tre njerëz të veshur me rroba të bardha hynë në Shesh, një fishkëllimë tronditëse u

dëgjua, edhe pëllumbat e bardhë në qiel u tremben, Astriti shikonte veten në spital, edhe atje e dëgjonte kitarën e Liridonit...

Para se të vdiste vetëm një fjali e tha: "Unë, Astrit Samiu, student i kimisë, dua të varrosem në Atdhe."

Në mbrëmje tërë bota foli se Kosova po kërkon liri edhe në Gjermani, se Sundimtari i kuq tërë botën e ka gënjer duke lëvizur me avionë të shpejtë, por edhe me karroca të Cejlonit, se shqiptarët në Kosovë i gjelqinë të gjitha të drejtat. Ndoshta, tha komentatori politik, Viktor Majeri, i gjelqinë të gjitha të drejtat shqiptarët që i ka pushtuar Sundimtari i kuq, por liri nuk kanë. Kanë të drejtë të vdesin, kanë të drejtë të ikin në Turqi, kanë të drejtë edhe të vrasin shoqi-shoin, por pse s'kanë të drejtë ta kenë Kosovën të tyre?

- Prapë do të kërkojmë liri në sheshe të Evropës, shkroi Liridoni në gazeten që e shprehte zërin e kitarës së tij...

## (SHQIPËRISË PËRNJËHERËSH I IKU GJUMI...)

Nënë Ajkunës disa herë ia kishin rrahur me shqelma derën e oborrit kukudhët që i kishte dërguar Sundimtari i kuq. Kot e keni, kishte thënë ajo, djemtë e mi nuk mund t'i kapni. A mund ta kapni diellin me dorë, a mund t'ia zini hijen hënës, nuk mund t'ia zini. Hënë e diell i shkëpusim ne nga qielli, ku i ke djemtë, ku është Liridoni? Ku e ka atë kitarën marroçe, që na shan e na mallkon me zërin e saj. Ju mund ta bëni copë-copë kitarën e Liridonit, por zërin e saj nuk mund ta shuan kurrë, - dhe e mbylli derën nënë Ajkuna. Kukudhët thanë se do të vijmë prapë, do ta djegim kitarën dhe shtëpinë. Nënë Ajkuna Hyri në dhomë, e mori nga

muri kitarën e Liridonit, e preku vetëm një herë një tel të saj, brenda atij zëri që kumboi teli, ajo pa:

...Sa mirë që jeni veshur me rroba ushtarake more bijtë e mi. E kaluat Bunën dhe nuk iu hetuan. Përtej Bune iu priti oficeri Marash Shpati. Një burrë i fortë, era po ia valëvit cepat e mantelit... Ka tri ditë që kohani si tē prishet. Qielli u mbuluq me re tē zeza, era po fërshëllen me tërbim.

Ushtari Blerim Kruma gëzohet. Trumbetat bijnë, dëgjohet edhe zëri i daulleve. Fytyrat e ushtarëve ngajnjë në gur graniti... Edhe shumë tē rinj nga Kosova e kanë kapërcyer Bunën. Enver Peja nuk ka kaluar përmes lomit, por i ka kapërcyer Bjeshkët e Nemuna. Nëse vritesh ti, mos tē vritem edhe unë... Nëse vritem unë, mos tē vritesh edhe ti...

- Hëpërhë Sundimtari i kuq më ka vrarë edhe mua, siç e ka vrarë edhe tërë Kosovën, - tha Marash Kruma, - por vrasjet do ta kenë fundin e vet. I shihni ato re, - ngriti zërin ai, - ato po ikin nga era, prapa tyre po hapet zjarri i diellit. Mos më thënçin Zija Shpendi,

më thënçin Zija Qyqja, nëse një ditë pa e pyetur Komandën në Tiranë nuk i kapërcej Bjeshkët e Nemuna me tanke e me avionë, me këmbësori, e unë vetë në krye të kolonës së këmbësorisë. Tepër e urtë kjo komanda jonë, edhe kjo pandeh se me demonstrata e me bisedime merr vesh Sundimtari i kuq, dhe të gjithë ata që i lë pas. Vetëm dhuna ua sjell në kokë mendët që s'i kanë. Mos u nxito, mos u nxito, - i thotë Liridoni, se nuk ishte në gjumë vetëm populli ynë në Kosovë, por në gjumë deri dje ishte tërë Evropa. Ajo pandehte se Kosova nuk ka halle, ngase Sundimtari i kuq kishte një aftësi të jashtë-zakonshme për të gënjer. Ka më tepër liri Kosova, thoshte Sundimtari i kuq, se që i duhet. Ndalja, pra, pak lirinë, ndalja pak... bënte sehir Evropa...

Nënë Ajkuna e preku edhe një tel të kitarës, prapë u përhap zëri i saj, në qosha të dhomës, ku e kishte thurur shtëpinë një merimangë e zezë, e dridhi një pe, ajo pandehu se i paloi krahët ndonjë mizë. Merimanga kurrë nuk do të dijë se ç'është zëri i kitarës, që e hetoi edhe një xham i thyer i

dritäres: nënë Ajkuna shihte brenda dridhjes së atij xhami një oficer shqiptar, e kishte të këputur njërën dorë. Ajo kurrë nuk kishte parë oficer me dorë të këputur, edhe dorën tjetër e ke të këputur, i fliste nënë Ajkuna, nëse nuk e shoh kalin tënd të bardhë në Dubovik. Lagjja Gjëmëmadhe nuk do të kishte më gjëmë... Oficerit iu këthyte dora e këputur, ajo u shkëput nga një copë qielli të Vishegradit, fluturoi si një çilim magjik mbi Tiranë, preku një nga një varrezat e dëshmorëve të kombit, hoçi një albër nga varri i shokut të vet që ishte vrarë në Vishegrad, dora u shndrrua në zë: "E mashtroi tërë Shqipërinë Sundimtari i kuq... I tha Shqipërisë se Kosova do të jetë jotja, se tërë jetën jotja ka qenë, por më parë eja ti e më ndihmo t'i ndjek fashistët edhe nga Vishegradi, e t'i o Ylli i Lumziut, o shoku im i sënjëjtës pushkë, o Ylli i Lumziut, nga Tirana deri në Pejë vetëm një pushkë kishim, e vrava një çetnik, ia mora pushkën, u bëmë me dy pushkë, e çliruam edhe Vishegradin, Sundimtari i kuq na tha që të kthehem sa më parë në Tiranë. E unë u ktheva pa dorën e majtë, ti u ktheve

ne arkivoli të bardhë, sa moti nuk të kam parë! - u dëgjua edhe njëherë zëri i kitarës së Liridonit, pastaj dora iu bashkua dorës tjetër, doli një zë urdhërues i oficerit:

Sundimtari i kuq deshi t'i fusë kthethrat e veta edhe në ushtrinë tonë, ai në fillim hyri në emër të internacionalizmit proletar me shumë ushtarë në Korçë, në drejtëm të Gjirrokastrës hyri ushtria greke, edhe ajo kishte një Piton në krye të kolonës, dy mbëdhjetë mijë gojë nxirrnin zjarr në Shqipëri, por i shpëtuam këtij zjarri të madh ngase tërë Shqipëria u zgjua nga gjumi, një zgjim para se të lindë dielli, një zgjim i përnjëhershëm, ushtarët e huaj ende ishin të dejur nga paralajmërimi me burbujë i suksesit në fushë të mejdänit...

Kitarja e dridhi edhe njëherë merimangën e zezë, ajo lëvizi drejt tokës me perin e vet të hollë, nënë Ajkuna e hetoi lëvizjen e saj, e mori me duar, e hapi dritaren, e hodhi bashkë me rrjetën e vet të dendur. Nga zëri i kitarës, që u bë më i kumbueshëm kur e mbylli dritaren nënë Ajkuna, doli një shkrimtar që e mbante fotografinë e Sundimtarit

të kuq te koka, sa herë binte në shtrat e shikonte atë me admirim, do t'ia varro si eshtrat poetit, i zotohej, poetit që herë këndon me kitarë, herë shkruan vjersha për kanjushën e verdhë, herë përkthen Kishin, lavdëron deri në kupë të qiellit Kadarenë. Edhe Kadaresë do t'ia hapi varrin, se po nuk ia hapa, ai nesër do të bëhet nobelist, Shqipëria bëhet edhe me një nobelist, kjo është vdekje për ne, o Sundimtari im, është dy herë vdekje për mua, se edhe unë ëndërroj të bëhem nobelist, se poezitë e mia, me urdhër të Sundimtarit tim janë përkthyer në serbisht, pritet që do të përkthehen edhe në gjuhë të tjera, në kinezisht së pari, se Sundimtari im, ndonëse haptas nuk ka miqësi me Kinën, ai me këtë shtet të largët e ka një miqësi të fshehtë, do t'ia prishë punën më parë Shqipërisë, pra do t'ia prishë miqësinë e hapur e pastaj e fshehta do të dalë në lëndinë, do të thotë ditë të pavdekshme po vijnë edhe për ata që do të vijnë pas Sundimtarit tim. Sa e dua Sundimtarin tim, po mos të ishte ky, unë s'do të flija në këtë dhomë të ngrohtë, s'do të kisha shëpinë trikatëshe,

s'do t'i kisha dy vetura. Punë e madhe që bëri vetëvrasje Shpëtimi, biri im i vetëm, kam edhe një vajzë, nuk do të lejoj kurrë që t'i bjerë kitarës, i urtej të gjitha kitaret e botës, unëurrej çdo zë të mirë...

Nënë Ajkuna e shikoi edhe njëherë kitarën, duke e shikuar në vetmi e zuri gjumi, edhe në gjumë bisedonte me kitarën e Liridonit...

## **(CIGANI QË E MASHTROI NLERİUN E PARË TË SUNDIMTARIT TË KUQ)**

Nënë Ajkunën e bashkonte edhe më shumë zëri i kitarës me djemtë e vet, e Prishtinën e ka mbuluar bulbëria. Ka hyrë pranvera në këtë qytet pas shirave dhe erërave të ftohta. Prishtina sa u përket rrobave, ka fituar të drejtën e vet. Nëpër rrugica, në oborre e sidomos në Gërmë pemët, lisat dhe plepat kanë lartësuar majat e tyre hijerënda. Gjithëkund është përhapur era e këndshme e jorgovanit, edhe aroma e luleve të tjera të dehë. Në tërë qytetin lajmet shqetësuese përhapen pa pushim. Kryetari ka urdhëruar të ruhet dinjiteti i njeriut, çdo shkelje e këtij urdhri do t'i u kushtojë shtrenjtë banorëve. Kryetari ka dhënë këto ditë edhe një urdhër:

"Qerret me kuaj nuk guxojnë të kalojnë nëpër qytet!"

Këtë urdhër e shkelën, ose nuk e shkelën të padëgjueshmit: u hipën kuajve, pas i lanë gjethet e blirëve që shkëputeshin nga degët. Milicët që iu dolën përpara s'kishin si t'i dënonin në bazë të urdhrit dhe të ligjit të Kryetarit, që ishte edhe ligj, edhe urdhër i vetë Sundimtarit të kuq. Kryetari ka urdhëruar, thanë kalorësit, që të mos i tërheqim qerfet me kuaj, ai nuk ka urdhëruar të mos u hipim kuajve..."

Një fshatar i zbathur, me një trastë në sup, pasi ngurron pak, sakaq merr guxim, shkëputet nga turma dhe i del përpara Komendantit, duke shtrënguar në dorë shajkaqën. Komandanti ndalet e i bën me dorë të flasë. Fshatari gëlltitet pak duke luajtur supin, kalon pëllëmbën tërë kallo mbi ballin e rrudhur e të përcëlluar nga djersa dhe thotë:

Jam Mirkoja i Graqanicës. Të them të drejtën, nuk kam qenë asnjëherë në Tregun e Prishtinës. Disa shitës, tek e dëgjonin që fliste kështu, qeshnin me njëri-tjetrin.

- Nuk ka ardhur asnjëherë në Treg dhe ku i qëlloj të takohet ballë për ballë me komandanin M. S. thotë një tregtar bezash.

- Po si e ke hallin?

Fshatari shtriu duart:

- Hallet e mia janë të shumta. I di zotërote më mirë së unë. Fytyra e Komandantit filloj të ngrysej. Asgjë nuk e bën atë të vuajë më shumë se sa brengat dhe hallet e popullit.

- As që kam ardhur të qahem për hallet e shumta që kam dhe që më kanë pllakosur në kokë! - belbëzoi Mirkoja.

- Po pse ke ardhur atëherë? - ia pret fjalën një lëkurëpunues me fytyrë të kuqe. Një bez të qëndisur me pafone bakri kishte në dorë.

- Pse u ndrydhe kështu dhe rri pezull as në qiell e as në tokë, përpara Komandantit, duke belbëuar? - qesh një grua me një fund të fryrë dhe një xhaketë të zezë. Ajo mban nën sqetull një shportë me lule.

- More, shikoni se mos është ndonjë nga ata të paguarit që futet, me veshje të maskuar, te Komandanti. - bërtet njëri nga për-

cjellësit më mjekër të kuqërrremtë. - I dimë ne planet e shqiptarëve - thotë tjetri.

- Po fshatari i bie në gjunjë Komandantit.

- Jam pesëdhjetë vjeç! - thotë.

- Edhe njëqind! - e uron me shaka një shitëse suxhukësh e boze, që ishte gorane.

- Dhe, i dashuri Komandant, që kur u ngrita një pëllëmbë mbi tokë, veç helm piva në kupë, - vazhdon pa u turbulluar fshatari.

- Helm e vrerë po pijmë të gjithë nga shqiptarët! - murmuriti shitësja e luleve.

- Më mori Stojani dhe më vuri të punoja si ka.

Asnjëri nuk bën më shaka. Buzëqeshjet u shuan.

- Punoja dhe më rrihte. Afro tridhjetë vjet kam punuar. Nuk ka kaluar muaj as vit, që kur mbaj mend në këtë jetë, që të mos më ketë rrahur, ankohet fshatari.

Shitësja e luleve pshëretiu rrëna... rrëna!

- Supet, brinjtë, kofshët, faqet dhe qafën, që nga atëherë i kam bllana, bllana të zeza futë dhe sytë iu mbushën lot.

Inspektori e rroku për krahun dhe e ngriti:

- Hajde, çou! Nuk e di që komandanti ynë nuk e lejon popullin t'i bjerë në këmbë.

Fshatari s'do të dijë:

- Kam qenë një kafshë. Ka një muaj që punoj te ILIRI, që më bëri NJERI. Ja, shikomëni të gjithë - Fshatari flak tutje nga supet xhuben dhe këmishën. - Është hera e parë që kam mishin pa njolla të zeza. Është hera e parë në jetë - tregon trastën që e mbante më parë në shpinë dhe tash ndodhej pranë gjunjve të tij, - që gruaja ime të më dërgojë edhe mua në treg të Prishtinës, si një njeri që vlej diçka, të shes pakëz lesh. - Me duart që i dridheshin, burri hapi grykën e trastës dhe nxori prej saj një bashkë leshi bojë hiri.

Komandanti, që ishte gjysmë dite komandant, gjysmë dite kryetar, tërë natën ishte dashnor i grave të shumta, e shikoi edhe njëherë leshin bojë hiri. I kam unë edhe katër dele, tha fshatari, kaq kam mundur të bëj prej që ka ardhur Sundimtari ynë, pastë jetë të gjatë, edhe jetën time ia falsha! Delet

nuk kam mundur t'i qethi kurrë vetë, fëmijët më kanë mbetur pa çorapë, - dhe nisi të qajë fshatari. Loti i rrođhi fytyrës, që dukej se ishte shtatëdhjetvjeçare. Kishte atë fytyrë të çfilitur. Pastë jetë të gjatë Sundimtarit ynë, se na dha leje që t'i shesim dhitë dhe delet, u ul pakëz tatimi.

Të gjithë kalimtarët nga rrugicat e afërta vrapuan pas zërit të fshatarit. Një i ri e ngriti dorën mbi sy, pastaj e shkundi dorën si të ishte e huaj, deshi ta qëllonte fshatarin.

- Të lutem, o Kryetar, që të kemi edhe Komandant, të kemi të parin e qytetit tonë, të kemi dorën e djathtë të Sundimtarit, ke mëshirë e prano këtë dhuratë që po ta fali, nëse nuk ma merr, më del shpirti.

- Çfarë dhurate?

- Këtë bashkë lesh bojë hiri, o i madhi ynë!

- E ke sjellë për të shitur, e ma fal mua, ç'është kjo?!

Dora e djathtë e Sundimtarit shtihet se po mallëngjehet.

- Merre të lutem...

- Me gjithë zemër ma jep?

- Me gjithë zemër ta jap, të lutem.
- Ne u ndihmojmë të varfërve.
- E di, por ti nuk e di, apo e di e ke harruar: kjo është pasuria ime e vetme, që ma fali një shqiptar, merre!

Komandanti përkulet i hutuar. E merr leshin që ia jep fshatari. I afrohet edhe një herë pranë gjoksit, ia shtrëngon dorën. Turma dendësohet pranë fshatarit që shtihet edhe më shumë i hutuar. Disa thoshin se nuk është i gjakut të Sundimtarit të kuq, të tjerët pohonin se është një shqiptar grindavec, kur mbetet pa para, luan role të ndryshme, ca të tjerë pohonin se imbrëmë e kanë parë me qeleshe të bardhë në kokë duke e ndjekur një të dejur me thikë në dorë, edhe vetë ishte i dehur... nuk e kishte qeleshen e bardhë, por të përhimtë e kishte, ngriti zërin një tjetër.

Dielli i mëngjesit i binte në sy fshatarit, ai nuk e hetonte fare, sytë ia vrante dielli Komandantit, i rrundhi sytë dhe krahët. Të gjithë në treg shkriheshin në ndenjën e një plaku shpirtmirë. Tregu nuk është vetëm ku shiten plaçkat, është një vend edhe ku njerëzit i mashtrojnë njerëzit e Sundimtarit të

kuq. Njeriu që ia fali njeriut të Sundimtarit të kuq leshin e deleve, ia kishte prerë dimrit shtatë dele një të diele kur binte borë edhe mbi çatinë e shtallës së tij dhjetë kilometra përtej Prishtine. Të nesërmen njeriu i parë në këtë qytet kishte dhënë urdhër që të ndiqen të gjithë ujqërit rreth Liqenit të Ballavës, të ndiqen në Gërmë dhe në Brezovicë, të ndiqen në të gjitha malet e Kosovës.

- Është, apo s'është shqiptar?

- Serb është, shtëpinë e ka në fshat...

Turma e njerëzve në treg kishte dy mendime, por ai i bashkoi dhe i shkrua në një: "As nuk jam shqiptar, as nuk jam serb, të gjithë jeni të marrë, cigan Asllani jam, gruaja ime është Sultanja, kur kishit dasma më njihshit, edhe gruan time e njihshit, pse i keni ndalë dasmat...?!"

Mete

## (BREDHI I LIRIDONIT)

Gjatë luginës së ngushtë të Lumit të Shpejtë, kudo mbi brinja, kishin lulëzuar gëmushat. Nëpër monopatin e pjerrët, akoma të njomur nga shiu i mëngjesit, ngjiten dubovikasit. Dikush ecte këmbë, dikush kaluar. Të gjithë shkonin në truallin e Bredhit, të gjithë ishin veshur me rrobat më të reja, burrat me tirq të bardhë, të qëndisur me gjatana, gratë me flokë të shtruara mbi shpinë, sa mirë ua pehatte era, e era gëzohej dhe lozte edhe me këmishat e bardha të fëmijëve. Fëmijët kishin veshur edhe jelekë të stolisur. Të gjitha ngjyrat e ylberit kishin zbritur në jelekët e tyre. Kolona e njerëzve dukej e bardhë, nga largësia as që vëreheshin gjajanët e zezë në tirqi. Në këtë bardhësi u

fut edhe një veturë me katër pasagjerë. Fisniku ishte ai që kujdesej për shoqërinë letorraine që po vinte. Festa e Bredhit ishte ndër më të lashtat në këtë katund. Vitin 1981, kishte thënë Liridoni, mund ta pagëzojmë me njëqind emra, por si jekët e ylbert në këmisha të bardha po i përgjigjet emri: viti i zgjimit. Që nga ky vit Kosova nuk ka më gjumë... Fshati ishte rritur edhe pas vitit 1981, po vendi ku rritej bredhi, sipas traditës; kishte mbetur po ai.

Bredhi ndodhej ballë për ballë me lagjen Gjëmëmadhe, herë ia merrte gjëmën lagjes, herë ia merrte gjëmën tërë fshatit, herë ia merrte gjëmën tërë Kosovës. Kur kërcenin vajzat rreth Bredhit dukej se kanë zbritur fluturat më të mira të botës, gjëma ikte. Djemtë i lëviznin gishtërinjtë në fyej, dikush e nis një hap, pastaj hapat bëhen valle, vallëzojnë vajzat me shporta lulesh në kokë, ndalet vallja, shportat vendosen pranë rrënjeve të Bredhit, krijohet një qetësi, dëgjohet edhe përpëlitja e një gjethi të bredhit maje tij, heshtjen nuk e duron më rapsodi, ai nis këngën për Bredhin, zërin e saj e dë-

gjojnë edhe shportat e luleve, e kush tha se nuk këndoijnë lulet? Acar, viti 1981, flnim në një dhomë, leckat mbulonin dy zemra që hetonin trokitjen në derë, streha e shtëpisë së vjetër ishte me akuj, dëgjohen hapat e njerëzve të Sundimtarit të kuq, kalldrëmit ecin shkujdeshëm kukudhët, në derë trokasın ata, kërkojnë të thellohen edhe më shumë plagët, në prak të derës e shkelin me këmbë një copë bukë misri, buka ishte e grabitur nga magjet tona, ishte shenjë e keqe që tregonte se do të shkelen edhe dy koka, do të shkelet edhe flamuri, ata nuk dinin se rrënjet e Bredhit nuk kalben kurrë, edhe po u kalben një ditë, mbillet bredhi tjeter, gjethet e Bredhit kurrë nuk veniten, ata këtë nuk e dinë, trualli i Bredhit është gjakndezur, fishekzjarret ngjiten në qiell, Bredhi prapë e shkund borën nga gjethet, kanjusha e verdhë prapë majë Bredhit...

Skënder T. i shikon edhe një herë shportat me lule, era ia shprush flokët, në një degë të Bredhit ka hyrë edhe Enver Peja, pranë tij Kadriu e ka bashkuar dorën me Trimin, potët hetojnë se po u ngushtohet kraharori,

njëri prej tyre qan, e ka njojur dhe e ka dashur shumë Liridonin, zemra e tij dridhet prapë, lotin ia heton edhe një zog që rri i struktur majë Bredhit. Profesori M. vazhdimisht e shikonte nënë Ajkunën, shihte në sytë e saj një Bredh edhe më të madh. Një poet tjétër, i ndërron syzat me nxitim, ecën në drejtim të Bredhit, ulet prapë pranë nënë Ajkunës, herët në mëngjes, shkruan ai në fletoren e vet të poezisë, apo Zjarri i Diellit të lindë, me gjakun tonë, nëse nuk bie shi, do ta vadisim Bredhin, Kosovës loti do ti ndalet, sa shumë lot kishte pasur Kosova, sa gjëmë të mëdha kishte pasur Duboviku, Bjeshkët e Nemuna kanë një fuqi magjike: janë kurriz që lidh Shqipërinë, kush tha që i ndanë, iu thaftë goja kush e tha këtë fjalë... Fole diçka? Jo, nuk fola, i përgjigjet ai nënë Ajkunës, shportat me lule i shikojnë vajzat, vajzat i shikojnë shportat me lule, korba unë, thotë në heshtje nënë Ajkuna, si nuk e mora kitarën e birit tim. Ajo e kishte fshehur në arkë kitarën e Liridonit, shkrimitari R. R. e shikon një gjeth që përpëlitet, duket se ia ka zënë

udhën një gjeth më i madh, ky që ishte më i vogël i lutet që të mos ia zërë udhën, nuk jemi të barabartë as për pehatje, as për bisedime, kur ti ke ngritur kokën mbi mua, si ta shoh unë diellin. Në gjethin që proteston shkrimtari R. R. shikon kitarën e Liridonit, në heshtjen e saj dëgjohet një zë kumbues: ngrite kokën, zemra ime, mjaft ke qëndruar në gjumë, ke vuajtur tmerrësish, shpërthe tash si lumi pas shiut, të dridhet tirania, u shoftë e u denoftë përjetë rrënja e Sundimtarit të kuq, kukudhëve ua marrtë nishanin balltaku.

Gjethi i madh pahetueshëm u shkëput nga Bredhi, u këput edhe dega e tij, kishte qëlluar degë me plagë, në rënien të saj një mjek shikonte gangrenën e babait të vet. Dega lëvizte drejt tokës, një erë mikluese e shoqëronte, një degë tjeter nisi të mbushej me diell, dega e thatë ende nuk ishte paluar për tokë, ajo lëvizte, e në atë lëvizje mjeku që shkruante prozë, shikonte babanë e vet që kishte ardhur në Prishtinë, ngjitej me krrutë në lagjen Kodra e Diellit, kishte

dëgjuar se i biri i tij kishte marrë banesë të re, një herë ishte gjëzuar shumë, pastaj ishte shqetësuar shumë: "Biri im nuk është më banor i fshatit ku lindi, unë s'mund të marr me mend sa i pikëlluar do të duket oborri im pa birin tim..."

Atë e bir rrinin në heshtje në banesë të re, vetëm një dritë e ndezur jiptë shenjë se banesa nuk është e shkretë, papandehur trokiti në derë Liridoni, u dëgjuan urimet për banesë të re, por gjëzimi nuk u hetua në sytë e plakut. Liridoni e njihte mjekun, ai ishte kujdesur për vajzën dhe djalin e tij, mjeku ia kishte lexuar poezitë Liridonit. Do të kthehem pas pak, tha Liridoni. Në banesë prapë heshtje, as nuk fliste babai, as nuk fliste i biri, sa ishte fajtor njëri, po aq tjetri, por faji përherë është i përbashkët; një trokitje prapë në derë, Liridoni hyri me kitarë në dorë, kitarja e tij nxori një melodi të lahutës, babai i mjekut e kishte një lahutë të vjetër në kullë, e kishin mbuluar merimangat, sikur e kishte harruar prej ditës kur kishte marrë lajmin se djali i tij do t'i merrë fëmijët dhe gruan në Prishtinë. Hë, hë! - tha plaku, dhe i vuri duart

në faqe, kitarja u shndërrua në fyell, plaku i binte fyellit, iu kujtua arka e nusës së vet ku e kishte fshehur.

- Të gjithë gurët që më vareshin në zemër m'i hoqe sonte, o Liridon, - tha babai i mjekut, në mëngjes iu kthyesh prapë fshatit. Në përpëlitje ishte ende dega e thatë e Bredhit, ajo u shtri në tokë, askush nuk e pa, vetëm sytë e mjekut ishin picërruar në të, ai shihte në atë rënien edhe vdekjen e babait të vet. Mbrëmja afrohej, kurorat e luleve e kishin mbuluar varrin e Liridonit në Gjermani, kurorat e luleve i kishin mbuluar edhe dy varre të tjera pranë Liridonit...

Mjeku që shkruante prozë brenda degës së thatë shikonte edhe varrin e habait të vet, e qortonte kryeplakun që fliste me të mëdhe në kullë edhe për Kombet e Bashkuara, e kishte harruar se varret ku do të varrosej nesër edhe ai nuk ishin rrëthuar me tela. Fëmijët nganjëherë harronin se po luanin futball mbi eshtra të njerëzve...

Mbrëmja po afrohej, shportat me lule mbeten te rrënjet e Bredhit, mjeku që shkru-

ante prozë u kthye në shtëpi të vet, u kthyen edhe vajzat dhe poetët në shtëpitë e tyre, u kthye edhe nënë Ajkuna, u kthyen të gjithë. Në mëngjes në tërë Kosovën një Bredh mori emrin e vet: Bredhi i Liridonit.

Mjeku që shkruante prozë i kishte vu duart në faqe, nuk donte t'ua prishë qetësinë fqinjëve, e dinte se brenda lagjes së tij është ende një kukudh, nuk donte t'ia prishte qetësinë as atij, se po ia prishi, ai do të vraponë i pari për të lajmëruar njerëzit e Sundimtarit të kuq se mjeku që shkruan prozë po e dëgjon Radio Tiranën, ai nuk do ta dëgjonte më, andaj i mbante prapë duart në faqe, e dëgjonte prozën e Ismail Kadaresë: "BALADË PËR VDEKJEN E J. G.", sa kujdeshëm lexonte spikerja:

## (BALADË PËR VDEKJEN E J. G.

Spitali i ri i qytetit të vogël Untergruppenbah (ai në të cilin dhjetë muaj më vonë, pikërisht, në një ditë të ngjashme, do të vdiste J. G.) u përvrura në mbarim të dimrit. Ishte ftohtë dhe kishte ende dëborë të pashkrirë në kopshtin dhe rrrethojën prej kangjellash të hekurta. Bardhësinë e saj, sidomos në ato vende ku ajo kontrastonte me tokën e zezë, kronisti i TV e shfrytëzoi me mjeshtëri në marrjen e tij, duke u gërshtuar me kontrastin që krijonin përparëset e bardha të personelit shëndetësor me kostumet e zeza të zyrtarëve e të të ftuarve të tjera në ceremoni. Ishte padyshim një rastësi, po në sfond të asaj pamje tingëllonin

vërtet bindshëm fjalët e drejtorit të spitalit, i cili pasi falënderoi qeverinë e Landit të Baden Vyrtenbergut për kujdesin e saj dhe pasi i siguroi qytetarët e Untergruppenbahut se ai bashkë me gjithë personelin tjetër do të bënин çmos që të përligjin këtë kujdes, e përfundoi fjalën e tij me mbyllje disi patetike, që bëri shumë njerëz të përloteshin. Të jeni të bindur, tha ai, se në këtë spitaljeta do të luftojë kundër vdekjes, drita kundër errësirës, e mira kundër së keqes. Do të luftojmë dhe do të fitojmë.

Ministrisë së Punëve të Brendshme të Landit të Baden Vyrtenbergut, Drejtorisë së Emigrantëve.

Unë i nënshkruari J. G. ish-qytetar jugosllav, me kombësi shqiptare, me profesion gazetar, i arratisur nga RF e Jugosllavisë për arsyе politike, duke falënderuar edhe një herë qeverinë e RF Gjermane për dhënien e strehimit politik, shfaq dëshirën time që, për arësyе sigurimi, të vendosem në Untergruppenbah.

Siç kam deklaruar edhe në kërkesën time për strehim politik, krahas punës sime si gazetar, do të merrem njëkohësisht, ashtu si edhe më parë, me letërsi dhe me muzikë.

Me respekt etj, etj.

Drejtorisë së spitalit të Untergruppenbahut. Në bazë të shkresës nr. 311 dt. 3.V.1980 të Ministrisë së Shëndetësisë së Landit të Baden Vyrtenbergut, bazuar në protokollin e bashkëpunimit kulturor midis RF Gjermane dhe Jugosllavisë, nënshkruar nga qeveritë e të dyja vendeve (pika 14 C e aneksit mbi këmbimin e përvojës profesionale) mjeku jugosllav G. Vidiç, kirurg, dërgohet në spitalin tuaj për një afat njëvjeçar.

Nga hetimet private për G. Vidiçin. Vidiç? Ishte një burrë i gjatë, afër të pesëdhjetave, apo ndoshta dukej aq për shkak të tëmthave të thinjur. Ishte profesionist i mirë, madje unë disa herë kisha bërë me vete pyet-

jen vërtet përfiton një gjë të madhe në spitalin tonë? Fliste mirë gjermanisht, ishte i rregullt dhe kishte fituar simpatinë e një pjese të mjekëve për gatishmérinë që tregonë për t'i zëvendësuar në rojën e natës.

Në fillim na i kërkonim me druatje një gjë të tillë, kishim përherë frikë se mos abuzonim me gatishmérinë e tij, po pastaj e kuptuam se e bënte këtë gjë me dëshirë. S'ka pse të druhemi, tha një ditë kolegu ynë. Ai është i huaj këtu dhe, në atë mënyrë jetese të mbyllur që bën për kalimin e mbrëmjes, roja e natës është pa dyshim formula më e përshtatshme, për të përdorur një shprehje tepër të kohës.

### Tjetër?

Çfarë të them unë tjetër? Ishte gjithmonë një tip i qetë. Veç e kapte një lloj trazimi, ndoshta kjo s'është fjalë e saktë, një lloj ankthi do të thosha, ndonëse edhe kjo s'është e saktë. S'di si t'ua shpjegoj, do ta quaja trazim, ndoshta edhe ankth, sikur të mos kishte një si pikë të ngrirë në vështrim. Afrohej te xhamllëku i madh i dhomës së pritjes, ja atje, dhe ashtu përhumbshëm

vështronte rrugën automobilistike. Nganjëherë të dukej se priste diçka apo ndoshta e jepte këtë përshtypje ngaqë ishte i huaj dhe dihet që për një të huaj rruga do të thotë diçka më shumë se përvendësin: andej vijnë letrat përtë, ndonjë pak o për Vitin e Ri, lajmet përtë vetët.

Ah, me që ra fjala për postën, desha të them se ishte veçanërisht i ndieshëm ndaj ziles së telefonit. Madje disa herë po ta vëreje me kujdes të jepte përshtypjen se ishte në përgjim të paprerë të tij. Po kjo ishte gjithashtu e kuptueshme për një të huaj, megjithëse duhet thënë se nuk mbaj mend t'i kenë telefonuar ndonjëherë të vetët, me përjashtim të ndonjë rasti, në mos gabohem në kujtesën time.

Dhe ky përgjim i telefonit mos u shpesh-tua kohët e fundit?

Nuk mund ta them një gjë të tillë, më kuptioni, ishte një gjë të them e rëndomtë, që edhe po të ndodhë vështirë se do të binte në sy. Një gjë mund të ishte me të vërtetë pakëz e habitshme, madje, që të jem i saktë duhet t'ju pohoj se tani që po e sjell ndërmend, po

më duket përherë të parë e tillë. Po, para se të vijë te kjo, desha të them se ajo turbullira për të cilën fola pak më parë, domethënë xhamllëku, ngrirja e vështrimit, rruga automobilistike etj. ndodhte sidomos sa herë që dëgjohej sirena e makinës së ndihmës së shpejtë, e asaj që sillte të aksidentuarit. Ishte ndonjë kujtim personal, tronditja para operimit të ngutshëm apo diçka tjetër, vështirë ta përcaktosh. Ai nuk ishte mjek i ri, dorën e kishte të sigurt dhe veç kësaj dihet që operacioni i ngutshëm i një të aksidentuarit të mbytur në gjak, ka gjithmonë më pak ankth se operimi i të sëmurit për të cilin kë ditë që përgatitesh.

Kështu që... ah, po e kisha fjalën të gjëja e habitshme që e përmenda pak më parë. Pra, të gjitha këto ishin të shpjegueshme njëfarësoj. E vetmja gjë që mund të dukej e habitshme ishte fakti se kureshtja e tij për telefonin (nuk e di në se fjala kureshtje është e përshtatshme për këtë rast,) pra kureshtja e tij për telefonin, në vend që të zbehej, me afrimin e makinës së urgjencës theksohej më tepër. Kështu, për shembull, e mbaj mend

fare mirë rastin kur pasi kishte vënë dorëzat e operacionit dhe maskën, për habinë tonë të madhe e hoqi në çast këtë të fudit për të pyetur "Mos po më kërkojnë në telefon?" Në të vërtetë zilja e telefonit po binte në sallon, dhe ai e vuri maskën vetëm pasi mori vesh se kërkonin dikë tjetër.

Po në ditën e shtatëmbëdhjetë janarit a foli në telefon me dikë?

Me sa di unë, jo.

Nga dëshmitë për natën e shtatëmbëdhjetë janarit, Zigfrid D., gjerman, banor i Untergruppenbahut, fqinj i viktimës.

Ora kishte kaluar dhjetën. Megjithëse nata ishte e ftohtë, kisha dalë në ballkon për të marrë ajër të freskët. Rruga përpara shtëpisë sime ishte e shkretë, kështu që e dëgjova fare qartë gërvimën shkaktuar prej hapjes së garazhit të J. G., prej nga ai bashkë me dy të tjerë po nxirrnin makinën. Një copë herë u morën me të, ngaqë, siç dukej, rruga kishte zënë akull dhe rrrotat rrëshqisnin. Më në fund u futën të tre në makinë, po nuk arritën

të nisen? Dikush u afrua nga e djathta dhe e qëlloj me breshëri makinën. Pastaj njeriu u largua me vrap. Dy tri sekonda më pas, ndoshta nga qoshja prej nga ia kishte behur ai, ndoshta nga ndonjë drejtëm që nuk e vura re, një tjetër njeri iu afrua makinës, nuk ishte i pari, sepse ndryshonte nga shtati, veç kësaj në vend të armës automatike mbante në dorë diçka të vogël, me siguri revolver ose bombë. Sa mbërriti te makina hapi derën e prasme dhe në çast u tërroq pas, sepse njëri nga viktimat u rrëzua në këmbët e tij. E kapërceu me këmbë trupin e tij dhe nëpër derën e hapur vështroi një grimë brenda makinës, pastaj u largua me vrap, njëlloj si i pari.

Ruga vazhdonte të ishte e boshatisur dhe unë hyra brenda për t'i telefonuar policisë.

Nga dëshmia e Petër S. polic. Kur mbërritëm ne (ora po i afrohej njëmbëdhjetës, në mos gaboj) njëri prej viktimave gjendej ende i rrëzuar përdhe, me fytyrë nga toka. Tjetri, ai që ishte në timon, dukej menjëherë që kishte ngrirë në vend ashtu siç e kishte zënë

çasti i vdekjes. Një grua, e shoqja, me sa dukej qante me kokën rrëzuar në timonin e makinës. I treti J. G., siç e morëm vesh më pas, vazhdonte të rrinte gjysmë i përkulur te dera e prapme, si njeriu që bëhet gati të zbresë. E shoqja i fërkonte ballin si dhe njërin krah. Flisnin të dy në një gjuhë të panjohur (shqip siç e morëm vesh më pas).

Sipas dëshmisë së Karl L., ndihmësmjek i spitalit të Untergruppenbahut. Makina e ndihmës së shpejtë mbërriti një minutë pas asaj të policisë. Dy nga viktimat kishin vdekur, madje ishin ftohur. I treti J. G. ishte gjallë.

Në kohën që po e ngrinim për ta vendosur në makinë ai tha: "Dua të bëj një deklaratë", gjë që tregonte se ishte në gjendje krejtësisht të ndërgjegjshme.

"Më vonë, thashë unë. Do të keni kohë më vonë.

Ndihej menjëherë që kishte shumë plumbë në trup. Gjatë rrugës përsëriti edhe njëherë dëshirën për të bërë deklaratën. Siç duket një ide e tillë e lehtësonte.

## Nga dëshmia e S. G., bashkëshorte e J. G.

Sapo u dëgjuan krismat kunata thirri e para: "I vranë!" Isha e veshur dhe u sula jashtë pa e pritur. Makina ishte disa metra larg hyrjes së garazhit, me farët ende të ndezur. Po unë nuk i hiqja dot sytë nga një gjë e zezë, në anën e djathtë të saj. Kur u afrova dhe pakë dallova që ishte një trup njeriu i rënë përmbyss. Rrëshqita, gati u rrëzova mbi të, gjersa e ktheva mbarë. Ishte K. Z. i vdekur.

Nuk e mbaj në mend si u ngrita. Mbaj mend vetëm që u gjenda te xhami i hapur nga ana e timonit. Ishte kunati i ngujuar në ndenjëse. Duart i kishte hequr nga timoni dhe i mbante mbi gjunjë. Sytë i kishte të myllur. Tepër i zbehtë.

I futa duart pas zverkut për t'i kërkuar plagët. S'kishte. Pa pritur i pashë vrimat e plumbave në faqe. Edhe ai kishte vdekur. Brenda në makinë ishte gjysmë terr dhe në krye s'dallova kurrgjë, ndjeva zërin e J. që tha:

- Çikë, qe ku jam.

Kështu më thërriste zakonisht, "çikë". Zërin e kishte të qetë të kthjellët. Apo ndoshta m'u duk ashtu prej fjalëve që shqiptoi. Kurse mënyra si qe mbledhur kruspull, me një dorë të mbështetur te shkallina e makinës, jepte, në kundërshtim me zërin, një mundim të madh.

- Oh, ia bëri kur e preka në shpatulla, - Aty i kam.

Kështu më tha, me siguri për plumbat.

Pastaj:

- Kjo dorë m'u mpi. Ma liro pak!

- J. më ndjen? - e pyeta.

- Në bark kam të tjera - foli ai.

S'dija sit'ia lehtësoja dhembjet.

- K. e shoh që ka vdekur - tha me vështrimin e ngulur nga kufoma në rrugë. - Shife B. te timoni.

U mata t'i thosha se vëllai ishte gjallë, po në atë çast u ndie kuja e kunatës, që porsa kishte mbërritur.

- Ka vdekur - tha ai.

- Ndoshfa jo.

Që nga larg u ndie një sirenë makine. Duhej të ishte policia ose ndihma e shpejtë.

Rruga gjer në spital ishte vende-vende e mbuluar nga bora. Ashtu pjesë-pjesë e mbuluar, me mpirje riprodhohej ajo më vonë në kujtesën e S. G.

Meqenëse nuk e lejuan të hipte në makinën e ndihmës së shpejtë, ajo e ndoçi atë me taksi. Dritat e prapme të makinës së spitalit regëtinin si të ngulura me turjelë në trupin e saj. Ishte e vetme. Kunata kishte mbetur me fëmijët që kishin arritur të dilnin gjithashtu nga shtëpia për të parë ç'kishte ndodhur.

Përpiqeji të kujtonte faktet e ditëve të fundit, gjëra që mund të kishin zgjuar dyshime, fjalë të J. për ndonjë rrezik të mundshëm; po nuk i kujtohej asgjë. Nuk i kujtoheshin as numrat e telefonave të miqve, të njerëzve të afërt. Qysh te shifra e tretë binte mjegulla. Pastaj te e katërtta, te e pestat... Shifrat e fundit këputeshin në humnerë.

I kujtoheshin vetëm ca parandjenja të këqija. Por edhe për to nuk ishte e sigurt në se i kishte dëgjuar diku apo i kishte menduar ajo vetë. Ishte thënë diçka për natën e 17 Janarit. Për 17 janarin e vitit 1467. Madje

ishte përmendur vdekja: Ah; po, një orë më parë e kishte përmendur J. Sot është dita e vdekjes së Skënderbeut. Kështu kishte thënë duke kthyer kokën nga kalendariku ishte një pikture e Degas, një balerinë aq e papërshtatshme për ditën e mbarimit të kryezotit mesjetar... E, megjithatë, tani i dukej se pikërisht ajo balerinë i sulej nga grumbujt e borës ndanë rrugës, drejt xhamit të veshur të taksisë, si për t'i kumtuar diçka. Diçka që ngjante herë si shpresë e dhimbshme, herë si një hare misterioze.

Në orën 23.20 J. G. gjendej i shtrirë në tryezën e operacionit. Në kohën që narkozdhënësi po i afrohej, ai bëri një gjest me dorë, si për ta ndalur dhe për herë të tretë tha se donte të bënte një deklaratë në prani të mjekëve dhe të një përfaqësuesi të ligjit. E futën policin Peter S. pasi i veshën me shpejtësi bluzën e bardhë dhe në prani të tij e mjekëve tha, më një zë që përherë të parë jepte shenjën e lodhjes: "Deklaroj se mua, J. G., vëllanë tim B. G. dhe shokun tonë K. Z.

i vau policia e fshehtë jugosllave... përtë vetmen arsy se ne luftojmë përtë drejtat e shqiptarëve të Kosovës... dhe që Kosova të jetë Republikë... Kaq kisha".

Dy mjekët, si edhe infermierët me maska, që gjatë deklaratës kishin qëndruar si të ngrirë, lëvizën pas fjalëve të tij "kaq kisha".

Në të vërtetë përpara se të vihej re lëvizja vetë, atë e dhanë rrezatimet e bisturive e duart e tyre.

Në valën e parë të turbullirës që i dha narkoza, i plagosuri i pa fytyrat e mjekëve si të ngitura me njëri-tjetrin dhe emrin "Vidiç" që mjeku i parë, që u përkul mbi të, e kishte shkruar te jaka, atij duhet të jetë dukur si Vilhelm ose Vili, përndryshe ishte ende në gjendje të bënte së paku një shenjë përtë shhangur mjekun me emrin e rrezikshëm.

(Në të vërtetë, ia nguli sytë një grimë për herë të dytë jakës së Vidiçit, tha më vonë infermierja Marta H. po nuk pati në vështrimin e tij kurrëfarë shenje pakënaqësie, pale pastaj frikë ose ankth. Pati vetëm një lloj habie, por edhe ajo e lehtë.

Që s'pati kurrëfarë shqetësimi e pohoi edhe polici Peter S., që ende s'kishte dalë nga salla dhe që, për shkak të deklaratës së porsabërë, hetonte me kujdes fytyrën e viktimitës.

Mungesa e shqetësimit vërtetonte se i plagosuri nuk e kishte lexuar saktë emrin e Vidiçit. Habia për të cilën foli infermierja, dhe që nuk u kundërshtua prej pollicit, mund të jetë shkaktuar prej tërheqjes së vëmendjes nga diçka e atypëratyshme, për shembull përse emri Vilhelm, ose Vili ishte shkruar me një V dhe jo me W.

Nëqoftë se kishte qenë kështu, atëherë kishte mundësi që në çastet e agonisë, në prag të humbjes së ndërgjegjes, V-ja ose V-të së bashku do të jenë vendosur e zhvendosur shumë herë mbi njëra-tjetrën, në përfytyrimin e tij me shpejtësi të ethshme siç ndodh në gjendje delirante. Dhe gjithmonë siç ndodh në gjendje të tilla objektet e përfytyruara, jo vetëm lëvizin me shpejtësi të çmendur po me të njëjtën shpejtësi marrin forma e kuptime simbolike nga më të lar-

mishmet ka mundësi që këto V të kenë marrë dhjetëra e qindra pamje e kuptime të ndryshme aty për aty, gjithmonë po të ndjekim këtë pandehmë, ahore mund të ketë ndodhur që midis qindra pamjeve ato V t'i kenë ngjarë viktimës, qoftë edhe për një grimë, me dhogat që vendosnin dikur pjetrtasi në varre, në vendlindjen e tij të largët, përpara se i vdekuri të mbulohej me dhe.

Nga hetimet krejtësisht private për Vidiçin.

Si qëlloi që Vidiçi kishte roje atë natë? Kishte radhën e tij apo si zakonisht zëvendësonte dikë?

Nuk më kujtohet saktë. Zëvendësimet që bënte ishin aq të shpeshta saqë s'binin në sy si të tilla. Më kuptioni ç'dua të them, zëvendësimet e tij prej kohësh na dukeshin të gjithëve si një gjë normale.

Ju kuptova. T'ju pyes për diçka tjetër. Atë mbrëmje kur mori rojën, a ishte po në atë gjendje si mbrëmjet e tjera? Desha të

them a erdhi si zakonisht apo me ndonjë farë ngutie, shqetësimi, apo me atë ndjenjë ankthi për të cilën folëm para ca ditësh?

Si të them nuk vura re një gjë të tillë. Më kuptoni kur nuk e ke mendjen në diçka të tillë.

Ju kuptoj. Po më pas, në kohën që u dëgjua sirena e makinës së ndihmës së shpejtë dhe sidomos kur u pa se viktima që ajo solli nuk ishte thjesht një i aksidentuar, po një viktimë e bërë shoshë nga plumbat, a pati ndonjë trazim të veçantë?

Si të them. Kur u dëgjua sirena nuk e pashë. S'di ku ishte, ndoshta pinte cigare në sallon. Kurse më pas, kur e zbritën të plagosurin, ne ishim aq të tronditur të gjithë, sa që vështirë që tronditja e dikujt mund të binte në sy. Qyteti ynë është i vogël dhe të masakruar të tillë nuk të bie rasti të shikosh shpesh.

E mori vesh Vidiçi ç'ishte i plagosuri?

Pa dyshim. Ai e bëri deklaratën në sytë e të gjithëve, midis një heshtjeje varri.

Nëse ju kujtohet, në kohën kur viktima

bënte deklaratën ç'shprehje kishte në fytyrë Vidiçi?

S'mund të them asgjë. Ne i kishin sytë të gjithë te fytyra e të plagosurit. Ishte aq tronditëse gjithçka sa që edhe tani ngjethem kur e kujtoj.

Operacioni i parë u bë prej Vidiçit dhe Weberit, asistentit të tij, apo jo? Pas këtij operacioni J. G. ishte gjallë, dhe përgjithësisht në gjendje të mirë. Në çoftë se Vidiçi do të donte të...

O ju lутем, zотëri, мос мë bëni pyetje тë tilla.

Unë po ju bëj një pyetje që është lehtësuese për Vidiçin... Pra, në qoftë se Vidiçi do të donte t'i bënte atë... ai kishte mundësi qysh në operacionin e parë apo jo?

Natyrisht.

Atëherë ç'ndodhi pas operacionit? Si ishte gjendja e tij shpirtërore? A ndihej mëdyshja, lufta e motiveve, lehtësi apo zyrtësia?

O, ju bëni pyetje tepër të vështira, zotëri, ju më premtuat se do të më bën fit disa pyetje të thjeshta.

Më falni, zonjushë që nuk e mbajtë dot fjälën. Është fjala jo vetëm për një jetë njeriu, është fjala për shumë shumë më tepër, besoni!

Ju besoj, zotëri.

A e kërkoi ndokush Vidiçin në telefon pas operacionit të parë?

Jo.

Po ai vetë a telefonoi? Kaldajisti thotë se ai mori në telefon dikë nga telefoni i bodrumit.

Ka mundësi të ketë marrë andej, unë nuk di gjë.

Dhe ka folur në gjuhën e vet.

Unë s'di gjë. S'e kam dëgjuar kurrë të flasë në atë gjuhë.

Si ishte gjendja e tij pas telefonimit? Desha të them gjendja e tij shpirtërore, aty rreth orës një pas mesnate?

Nga pohimi i rastësishëm i kaldajistit Johan T.

Vidiçi foli nga telefoni i bodrumit në orën një pas mesnate. Duhet të ishte fill pas

operacionit të parë, sepse në mëngët e përparëses kishte ende njolla gjaku. Zërin e kishte të lodhur, të munduar. Ai sa vinte i dobësohej, kurse në fund të bisedës yuri dorezën e telefonit, mbështeti ballin mbi aparat dhe ndenji mjaft kohë ashtu. Kishte pamjen e njeriut krejtësisht të dërrmuar, saqë një çast m'u duk se po çante dhe u bëra gati ta pyesja, "Ç'keni kështu zotni?" Por e mbajta veten, ngaqë ai nuk më kishte vënë re dhe mendova se ndoshta do t'i vinte zor që po e shihja në një gjendje të tillë.

"Në orën 1.10 pas mesnate në kujtesën e S. G. erdhi numri i parë i telefonit. Pas tij u çliruan të tjërët. Njëri pas tjetrit vinin nga sferat e panjohura ku ishin tërhequr. Kur ajo formoi numrin e parë ndjeu duart t'i dridheshin dhe vetëm atëherë e kuptoi se sa fort i kishte copëtuar gishtat gjatë gjithë kohës që kishte vazhduar operacioni. Alo, jam S. Tim kunat e vranë para dy orësh, K. Z. gjithashtu, J. porsa doli nga salsa e operacionit. Është plagosur rëndë. Narkoza ende s'i ka dalë.

Në orën 2 ende s'kishte mbërritur asnjë nga miqtë. Ishin larg në qytete të tjera dhe koha qe krejt e papërshtatshme për të nxituar në rrugët e akulluara.

Në orën 2.30 pritej dalja e narkozës.

Në orën 2.40 asaj i dhanë përsëri një qetësues të reanimacionit. Ç'është? mendoi ajo. Pastaj e bëri pyetjen me zë. Një ndihmësmjeke i tha që të mos shqetësohej. I plagosuri kishte një keqësim të lehtë dhe po i bënin një gjilpërë. Janë gjëra të zakonshme pas një operacioni të tillë, i tha ndihmësmjekja.

Në orën 2.52 trazimi nuk po qetësohej në reanimacion.

Në orën 3 ora ngjante si e mbetur në vend.

Në orën 3.10 truri i saj i lodhur kapi fjalën "operacion". Iu desh disa sekonda sa ta dallonte nëse e kishte dëgjuar vërtet apo ishte brenda mendimit të saj.

Në orën 3.11, e kuptoi të vërtetët dhe pyeti me dënesë: Përsëri operacion? A është e mundur? A është e nevojshme?

Astnjë nga miqtë nuk kishte mbërritur ende.

Ejani në sallon zonjë. Ky është një operacion i thjeshtë. Shumë më i thjeshtë se i pari. Ka mundësi të ketë ngelur ndonjë plumb i fundit. Mos u shqetësoni.

Në orën 3.15 ajo ndodhej përsëri në kanapenë e sallës së pritjes, Duart i kishte të akullta dhe në mendje iu krijuan prapë zona boshe.

Iu duk se që jashtë u dëgjua frenimi i një makine, por e harroi sakaq.

Një infermiere, ajo që i dha qetësuesin e fundit, u ul pranë saj në kanape.

- Nga jeni? - e pyeti me dhimbshuri. - Nga e folura ndihet që jeni e huaj.

- Jam shqiptare nga Jugosllavia, - tha ajo. - Nga Kosova.

- Nga Jugosllavia? - tha infermierja. - Sa mirë paska qëlluar, mjeku që po e operon burrin tuaj është jugosllav?

- Si???

(Nuk kisha parë ndonjëherë vështrim që mund të shkatërrohet një çast, si në filmat me tmerre, kishte thënë infermierja).

E çmendur, gruaja kishte rendur përjashta nëpër korridor, tamam në kohën që mjeku Vidiç apo kishte dalë nga salla e operacionit dhe po i thoshte diçka një të panjohuri.

Ajo nuk i dëgjoi fjalët e mjekut në fillim, as e njuhu të porsaardhurin, njeriun që e kishte kërkuar të parin në telefon, në kohën kur u bë e aftë për një gjë të tillë... ajo dalloi vetëm tre gishtat e mjekut të ngritura përpara fytyrës së të panjohurit, siç bëhet në rastet kur tjetri nuk e kuption mirë gjuhën.

- Çfarë? - pyeste me egërsi i panjohuri dhe mjeku vazhdonte të mbante përpara tij, skeptër të mynxyrshëm, cfurk tredhëmbësh të Posejdonit, tre gishtat e tij.

- Të thashë një herë, kanë vdekur të tre.  
- C'po thua, rrezikzi, - thirri i panjohuri.  
- Po mua më thanë se njëri është gjallë.

Në atë çast ai ndjeu praninë e gruas dhe iu kthye asaj, për ta përqafuar, për ta ngushulluar, për ta pyetur se ç'ka po fliste ky i çmendur, kurse e vërteta, siç ia kishte thënë ajo në telefon, duhej të ishte krejt ndryshe.

Po gruaja nuk shihte kurrgjë. Sytë e saj vështronin vetëm një pikë te jaka e mjekut, atje kù në një pllakë të vogël plastike blu, ishte shkruar emri "Vidiç"

Ajo e afroi kokën edhe më shumë mbi atë pllakën, pastaj e kapi mjekun nga përparsja e bardhë si të donte ta rrëzonte atë.

- Ti e vrave! - klithi me zë të qjerrë. - Ti si za ubije W.

I bardhë në fytyrë si gëlqere mjeku u mbajt me një dorë nga muri, ndërsa gruaja vazhdonte të klithte në gjuhën serbe.

Gjatë gjithë kohës që vazhdoi kjo skenë e rëndë, ai nuk iu përgjigj asaj asnjëherë në serbisht, pohuan dëshmitarët. Ishte tejet i tronditur; dukej çdo çast se do të rrëzohej, gjersa ndërhyjnë dhe e larguan gruan.

J. G., emigrant politik shqiptar, arratisur nga Jugosllavia, me nënshtetësi gjermane, gazetar, poet dhe muzikant, vdiq më 17 janar në orën 3.15 pas mesnate, gjatë operacionit.

Ky ishte shënim i përmbarimin e tij në librën e spitalit të Untergruppenbahut.

Policia nuk arriti asnjëherë të zbulonte vrasësin. Akuzat e bashkëshortes të tij kundër mjekut Vidiç, megjithëse të formuluara nga një avokat i dëgjuar, nuk u morën parasysh përmungesë provash.

Mjeku Vidiç u largua nga Untergruppenbahu qysh të nesërmen në ditën e ftohtë, të ngjashme me atë të cilën kishte ardhur. Veç se në ndryshim me ardhjen, largimi i tij nuk figuronte në asnjë shkresë, protokoll ose shtojcë protokolli.

Për të u fol njëfarë kohe në rrethe të ndryshme, por ato që fliteshin ishin në përgjithësi gojëdhëna. Delire të ndryshme të sëmurësh në spitale psikiatrike, pendesa, vrasje ndërgjegjesh, etj. u dhanë disa herë si të tilla por asnjëherë nuk u saktësua kjo gjë.

J. G. u varros në varrezën e Shtutgardit. Ndërsa kërkonin një tekst sa më dome-thënës për t'ia gdhendur mbi varr, njerëzit e familjes dhe dashamirësit e tij dëgjuan me radhë disqet me këngë e balada që ai i kishte

shkruar, kompozuar dhe kënduar vetë, pjesën më të madhe të shoqëruara me kitarë.

Duke i dëgjuar në heshtje, ata erdhën në një mendje, se shumica e këtyre teksteve ishin të përshtatshme për t'u gdhendur në mermerin e varrit. Kjo binte në sy kaq qartë, saqë një ditë, në një nga ato ditë kur e qeshura dhe humori rifituan më në fund të drejtën të pranoheshin në bisedat për kujtimin e të ikurit, si për ta bërë edhe më brilante dhembjen, njëri nga miqtë e tij tha se kishin të drejtë të akuzonin J. se kishte përgatitur ai vetë vrasjen e vet.

Teksti i mbishkrimit u zgjodh më në fund prej njérës prej baladave të tij, po drejtoria e varrezës nguli këmbë që të bëhej një ndryshim në të. Ishte prerja, ose, për të përdorur një fjalë më të kohës, censurimi i fundit që iu bë J. G., në jetën e të cilit kishte pasur disa herë ndërthurje të tilla, duke e përfshirë këtu edhe vdekjen e tij, e cila, në fund të fundit, nuk ishte veçse një prerje.

## (NË DUART E TIJ KITARA LOZTE VETË)

Ishim mbledhur një natë dhe po festonim ditëlindjen e djalit të tij. Tashti nuk më kujtohet se cilin vit festonim, por ajo natë mbeti një kujtim i përjetshëm përmua. Patën ardhur edhe fqinjë e miq të tjerë. Kishte aty gazetarë, poetë e muzikantë. Nga të gjithë krijohej atmosfera që kërkohej. Po nuk di se si ndodhi e dikush rikujtoi fëmijërinë. Ishte një rikujtim i sinqertë që po tregohej jo vetëm atë natë të vonë. S'di se si ndodhi të tregonim secili prej nesh nga një kujtim fëmijërie. Një kujtim të tillë e tregoi edhe ai.

E dëgjuam të gjithë me vëmendje. Ishte një kujtim i hidhur që e tregonte në mënyrë të tij vetë poeti. Së fundi ai tha:

"Isha nisur me babanë për të shkuar në qytet. Kishim për të shitur dy thasë grurë. Ngarkuam kalin dhe vendosëm dy barrë të rënda mbi shpinën e tij. Sa m'u dhimb që e ngarkuam, po nuk bënte ndryshe. Pa shitur atë grurë nuk i përballonim dot kërkesat e shtëpisë. U nisëm për në qytetin Gj. Atje thoshin se shitej më mirë gruri. Atje kishte edhe blerës të shumtë. Dhë vërtet ashtu edhe ndodhi. Grurin e shitëm shpejt, kurse dita ishte para nesh. E luta babanë që të shkoja te lumi dhe të lahesha një çikë. Ai më lëshoi po më tha që të mos vonohesha tepër se koha kalonte e ne duhej të ktheheshim pa rënë terri. Çdo gjë do të ishte në rregull sikur unë të dija të notoja, por nuk ishte ashtu. Unë vërtet kisha provuar të mësohesha në ca lumenj jo të thellë, po të hyja thellë nëndonjë lumë akoma nuk isha i gatshëm. Në lumin që hyra, m'u duk i cekët, dhe, po kërkova të tregohesha më guximtar e të futesha më thellë. Para meje ishte një ngushticë lumi

që tregonte se aty ujët ishte mbledhur dhe se mund të ishte më thellë. Megjithëkëtë, mora guxim dhe u futa deri në bel, por për fatin tim të keq aty fillonte thellësira e lumi. Përnjëherë këmbët e mia të vogla nuk e prekën dheun. Më humbi toka, më humbi siguria dhe më zuri një frikë e madhe. U mundova të shikoja nga brigjet e lumi për të parë ndonjë njeri që do ta thërrisja po të gjendesha në rrezik, por në atë shpejtësi nuk pashë askë. Vetëm më larg dëgjova zëra fëmijësh që po thërrisin njëri-tjetrin. Dherashë i téri në atë thellësi. Më përlau vala dhe u futa s'di se sa thellë. Provova të lëvizja duar e këmbë, por në atë çast nga frika humba rendin e lëvizjeve. Mendova të merrja forcë dhe të provoja të dilja edhe një herë në sipërfaqe të ujit për të marrë frymë. Dheria dola. Mora frymë, provova të bëja ndonjë përpjekje për të notuar, por më kot. Sërish u fundosa. Tashti më lëshonte fuqia, më lëshonte forca. Më dukej se do të mbaroja përgjithmonë e s'do ta shihja më diellin. Prapë u fundosa. Prapë këmbët më prekën në tokë. Prapë pasigurinë ma shtoi vala e re

që më frikësoi edhe më tepër. Thashë vetë më vete të dal edhe njëherë në sipërfaqe. Provova duke mbledhur të gjitha forcat. Dhe, ia dola. E pashë dritën, i pashë prapë brigjet, arrita të bërtisja, Ooo! po nuk arrita të thosha ndonjë fjalë tjeter më të qartë. Natyrisht mora frymë dhe prapë u zhyta në ujët e thellë të lumit. Isha i vetëdijshëm se ç'po ndodh me mua. Së shpejti do të më zihej fryma e do të dorëzohesha. Rashë përsëri në mëshirën e thellësisë. Mendova: edhe njëherë ndoshta do të kem fuqi ta nxjerr kokën mbi ujë e për më tepër nuk i besoja vetvetes. Mblodha tërë fuqinë dhe nxora kokën e një pjesë më të madhe të trupit mbi sipërfaqe të lumit e pastaj provova të notoja ashtu si dija e të shpëtoja nga ky kurth i lumit. I dhashë me gjithë forcën që më kishte mbetur, nxora edhe krahët mbi sipërfaqe dhe dola nga ajo thellësi që donte të ma merrte jetën. Sa dola në cektinë më ra të fikët, po tashti nuk ishte rrezik se lumi nuk më merrte dot. Nuk di sa kam qëndruar kështu, kur një dorë më zuri për krahun e djathë.

- Eja, bir, - më tha, dhe më ngriti lart.  
Ishte babai, që më kishtë ardhur prapa dhe  
që po më ngrinte nga ai lumë.

- Po pse, ç'ka ndodhur kështu me mua?  
- pyeta duke ardhur në vete.

- Përpak sa s'u mbyte o bir. Të pashë që  
larg po nuk të arrija dot. Gjithë përpjekjen  
tënde për të dalë nga lumi e pashë me sytë e  
mi.

- Po a s'të qortoi fare? - pyeti dikush nga  
të pranishmit.

- Jo. vërtet s'më qortoi. Vetëm se kur e  
shikova pashë një lot të tij në cep të syrit

Pas këtij përjetimi dikush tha:

- Përpak të mbeteshim pa një poet!  
- Besa edhe pa një muzikant, - vazhdoi  
Ylli.

- Edhe pa një gazetar, - shtoi dikush  
tjetër.

- Nejse, kjo ka qenë e kaluar, është me  
rëndësi që J. është gjallë e sonte na ka ftuar  
për ditëlindje të djalit. Ajo qoftë e shkuar  
dhe e harruar. - Ishte Dreni, vjershëtar i ri që  
e çmonte shumë J. G. dhe e cyste të punonte

më shumë se kish besim se do të bëhej një poet i mirë. Temat që trajtonte ishin më shumë sociale, të këtij mjetisë. Ndoshta edhe mu për këtë e donte dhe e admironte punën e tij.

Pas kësaj bisede që ishte sa e dhembshme aq edhe interesante, Yllka, një këngëtarë e njojur e qytetit, tha:

- E po mirë, tashti pasi treguam kujtime nga fëmijëria, a s'është më mirë t'ia marrim ndonjë kënge?

- Po edhe për këtë jemi mbledhur, - nuk e fshehu gjëzimin J. G. - Do t'ia marrim mirë e shtruar sa të dëgjohet edhe në mëhallën tjeter, - bëri shaka. Kënduam sa kënduam kur dikush përmendi vargjet. J. G. u ngrit, doli nga dhoma, në korridor, ku kishte bibliotekën dhe nga një dollap i saj nxori një dorëshkrim - një tufëz vjershash të shkruara kohë pas kohe.

- Ja, - na tha, - këtu jam duke bërë gati përbledhjen e re me vjersha.

- Zgjatëm qafat dhe u përkulëm mbi vargjet e tij.

- Si do ta pagëzosh? - pyeti Zamira, njëra nga fqinjet e para të ndërtesës ku banonte.

- Si do ta pagëzoj? - poetit i ndritën sytë, po në ballë iu duk një rrudhë e cila formoi edhe disa të tjera më të holla po të thella si edhe e para.

- Kanjushë e verdhë, - tha J. G. duke shikuar diku larg, duke hedhur sytë përtej largësive apo përtej hallevë e mendimeve që e mundonin.

- Po pse e verdhë? - pyeti Nora, një nxënëse që thoshin se do të bëhet operiste. Kishte një zë karakteristik e një shpirt shumë suptil. Ndiente dhembje e për çdo imtësi asaj i dhembeshin shumë zogjtë.

- Përse e verdhë? - tha prapë poeti. - E verdhë sepse është e verdhë koha në të cilën jetojmë, sepse është e verdhë flaka që del nga gjiri ynë, - tha ai dhe doli nga dhoma. Nuk e di a u pikëllua pse nuk ia kuptuam simbolikën e titullit të vjershavë apo ashtu deshi ta kalonte këtë hop të jetës.

Kishte kaluar mesnata kur Zamira po i lutej prapë të merrte kitarën dhe të kë-

donte ndonjë këngë të tij të komponuar rish-tas.

- Po, ju lodha, - tha e një buzëqeshje e zbuloi aty për aty.

- Diçka që ke komponuar këto ditë, - e luti edhe dikush.

Ai mori prapë kitarën, shoqen e tij të jetës dhe filloi t'i bjerë. M'u duk se dëgjoja Drilonin kah rriddhte fushave dhe maleve. M'u duk se me melodinë e zërin e tij karakteristik, të ëmbël, e të butë po i zgjonte të gjitha kanjushat e të gjithë zogjtë tjerë të Kosovës.

Ia hodha krahun rreth qafe dhe zura ta shoqëroja. Me ne u bashkuan edhe të tjerët. Pas mbarimit të melodisë që donte t'ia gente fjalët se kush tha: Në duart e J. kitara loz vetë...

Kur u ndamë nga ajo natë që s'ishte më natë po ferku i mëngjësit, andej nga lindja qelli ishte skuqur. Edhe pak e do të lindte dielli...

## (EPILOGU APO RRËFIMI PËR NUMRIN SHTATË)

Mjeku që shkruan prozë nuk do ta lëshonte kurrë vendin e punës, por e qëlluan me kondak të pushkës në kokë dhe në gjoks, i thanë se nuk kemi ardhur që të bëjmë sehir me ju shqiptarët në Kosovë, se edhe ne i kemi fëmijët dhe gratë në Beograd, por kemi ardhur që t'i u asgjësojmë. Ty dy herë të kemi thënë që të mos vish më në punë, edhe natën ke ardhur dhe na ke lodhur me atë sentimentalizmin tënd që ke ndaj patientëve, u rri te koka, nuk lejon që të vdesin. Ne duam që të vdesim të gjithë patientët tuaj, duam që të sëmuren të gjithë ata që flasin shqip, të vdesin që të gjithë, vetëm atëherë policia jonë e ka kryer misionin e vet që i është besuar.

Mjeku që shkruan prozë e shihte se plagët në kokë kanë filluar t'i shërohen, ato në gjoks kishin qenë më të vogla, syri i majtë që ishte mbyll nisi ta merrte dritën prapë, ai e shikonte prapë radion, dëshironte që ta dëgjonte edhe njëherë tregimin që e lexoi spikerja, por ajo nisi të flasë për arratisjen e disa të rinjve me anije shqiptare për të ikur nga Shqipëria. Unë tërë jetën ëndërrroj dhe në ëndërr njëqind herë kam ardhur në Shqipëri, tha mjeku dhe i mallkoi të gjithë njerëzit që ia kthejnë shpinën tokës që i ka lindur. Mos qofsha unë Alban Hylloshi, tha ai, nëse nuk ia shkruaj sot një letër OKB-së, pse vrasësi i personazhit kryesor të tregimit: "Baladë për vdekjen e J. G. nuk është kapur ende nga policia gjermane, nuk ka dalë në gjyq, nuk është njoftuar as Gjermania, as Shqipëria, as familja e të vrarit për një vrasës të zi që ka veshur rrobat e bardha.

Alban Hylloshi doli nga shtëpia e vet, eci ngadalë drejt Gërmisë, avionët e luftës sa nuk i preknin majat e maleve. Ai në ato male shikonte Krujën, Skënderbeu vinte hipur në kalë, një shpatë e madhe e prente mjegullën,

e prente edhe një guri të zi, një çallmë e madhe rrokullisej në përrua...

Alban Hylloshi u ul pranë një kroi, tutje ishte një pishinë e madhe, e dinte ai se nën pllakat e shkruara e të ftohta të saj ishte dikur ujësjellësi i qytetit Prishtinë, e dinte ai se pishina as që do të ndërtohej po mos të ishin tubat e atij ujësjellësi, ndërtuesit që kishin ardhur nga Karpatet donin ta fshinin nga faqja e dheut tërë të kaluarën tonë, donin ta fshinin edhe nga thellësia e tokës, donin ata t'i sillnin sorrat e zeza dhe të krrokasin mbi varrin e përbashkët të të gjithë shqiptarëve. Alban Hylloshi hetoi se si iu rrokullis faqeve një pikë loti, e fshiu me dorë, nuk lejoi që loti të bjerë në ujin e kroit, piu edhe pak ujë, eci drejt një bredhi, iu kujtuan bredhat nën një përmendore të çuditshme të Kodrës së Diellit. Pasi erdhi në pushtet Sundimtari i kuq, tha ai, punën e parë që bëri në Prishtinë ishte mbjellja e bredhave mbi varrezat e moçme të shqiptarëve dhe të hebrenjve. Janë kujdesur shumë shqiptarët për hebrenjtë, patën lidhur një miqësi të thellë, atë miqësi do t'ia

tregojnë edhe Izraelit, ai sot nuk është shtet, por nesër do të bëhet, e do të lindë një miqësi edhe më e madhe në mes të Shqipërisë dhe Izraelit, andaj bëni rrafsh me tokë varret e shqiptarëve dhe varret e hebrenjve, mbillni sa më shumë bredha mbi ata eshtra, kishte thënë Sundimtari i kuq. Në fillim fjalët e tij dukeshin se janë ëndrra të një njeriu të së-murë, por ai fjalët i shndërroi në urdhër, eshtrat e dy popujve u derdhen në përrua, nuk vonoi e një shi i madh i nisi ata eshtra drejt Detit të Zi. Lumi i Bardhë kurrë nuk kishte qenë më i pikëlluar. Alban Hylloshi u ul pranë bredhit, ia shikoi rrënjet dhe trupin, në trup dikush kishte shkruar emrin e vet, ishin skalitur edhe dy zemra... Bredhi ishte rritur, ishin rritur edhe zemrat, se a janë bashkuar, apo janë ndarë nuk e dinte askush, bredhi heshtte...

Mjeku që shkruan prozë e shikonte prapë majën e bredhit, atje shihte prapë flamurin e Skënderbeut, valëvitej i lirë, dikur nisi të dridhej bredhi, flamuri u shkëput nga maja e bredhit, deshi të binte në tokë, vrapuan trimat e Skënderbeut, të gjitha gjethet

e bredhit nisën të lëshonin lot, e dielli ishte në qìell, ishte një acar i madh, ishte pikërisht 17 janari i vitit 1467. Bora kishte ngrirë tërë fushën mbi Krujë, lisat kërcisinin nga acari, dielli i kishte rrezet mashtruese... Diell me dhëmb, i ka thënë edhe Skënderbeu, e dielli nisi të humbë në errësirë, dhe ia ktheu shpinën Lezhës, një gjëmë e madhe u dëgjua në tërë Shqipërinë, gjëma i kapërceu të gjitha malet dhe fushat, ajo trokiti në të gjitha shtëpitë e Evropës, të gjitha i shpalosën flamujt në shenjë zie, pushtuesit aziatikë, thoshin të gjithë njerëzit e Evropës, tash do të na robërojnë, medet pse vdiq mbreti i Shqipërisë.

Mjeku Vidiç, nisi t'i flasë bredhit në heshtje Alban Hylloshi, kishte mësuar nga zyrat sekrete të Sundimtarit të kuq se pikërisht më 17 janar 1982 duhet të vritet edhe Liridoni. Nëse atentati nuk ka sukses, i kishin thënë në ato zyra, ti duhet të keshë sukses, i ke gërvshërët në duar, ke edhe thikën e operatorit, urdhëro që narkoza të jetë me një dozë edhe më të madhe, po iu shkurtua

jeta pikërisht në këtë ditë Liridonit, do të zgjatet jeta jote, ti je mjek e mund të thuash se nuk lejon etika e profesionit për vepra të tilla. Por, kur është fjala për vrasjen e një poeti që shkruan vargje aq të mira për Shqipërinë, duhet ta harrosh etikën. Jo, unë etikën e kam harruar qysh tash: pasi Liridoni paska kërkuar që edhe Kosova të bëhet Shqipëri, bile edhe paska thënë se Kosova Shqipëri ka qenë edhe në kohën e Skënderbeut, unë pikërisht më 17 janar 1982 do ta vras. Ai vjen për t'u shëruar te unë, e unë do ta vras, askush nuk do të pandehë se Liridonin e vrava unë... Edhe nëse zbulohet vrasësi, unë kam gjashtë vëllezër të tjera dhe dy motra me gruan e dytë të babait, pra jemi gjithsej tetë fëmijë të një babai bujar, nuk venitet rrënja jonë, e lëre më të shkëputet, siç paska thënë Liridoni. Do ta kem pak më vështirë nëse vijnë të plagosur që të tre, se për një jam i gatshëm në sy të njëqind mjekëve t'ia preku zemrën me majë të gërshterëve dhe të mos më hetoj kush. Po them edhe një herë: unë kam gjashtë vëllezër e dy motra,

nuk është pak. I biri i Sundimtarit të kuq, që u bë sot sundimtar edhe i gjashtë vëllezërve dhe dy motrave të mia, do të jetë njeriu më i lumtur në botë, do t'ia vraç njeriun që kërkonte liri, edhe emrin e kishte protestë... Liridoni është përzier edhe në gjakun tim: ka thënë se një ditë do të hyjë hasmëria në mes të gjashtë vëllezërve dhe dy motrave të Vidiçit, ajo hasmëri do të rritet si lumi pas shiut, do të ndahen në tetë shtëpi, por para se të ndahen do ta vrasin shoqi-shoin. Bota do të çuditet me vrasjen e vëllezërve dhe motrave, e vetë bota do ta merrë vesh më vonë se nuk ishin as vëllezër, as motra, por ishin tetë kopila që i kishte bashkuar me zor Sundimtari i kuq. Le të flasë ai çka të dojë, por mos të harrojë se thika ime do t'ia prekë Liridonit majën e zemrës dhe do ta therë.

Alban Hylloshi po shikonte prapë majën e bredhit, do ta shikonte edhe më gjatë, por majë një lisi të moçëm, që ishte pranë bredhit, u ndal një sorrë e zezë, e hapi sqepin në formë të shkronjës V, e përbiu një mizë, prapë e hapi sqepin sorra e zezë, prapë e soll

majë këtij lisi shkronjën V. Alban Hylloshi në atë shkronjë të sorrës së zezë shikonte prapë mjekun Vidiç që ngjitej shkallëve të avionit, sa shpejt mbetën prapa shumë qytete të Gjermanisë. Lumenjt e këtij shteti dukeshin të ngrirë, çdo gjë e ngrirë dukej në sytë e Vidiçit, por në avion bënte nxehthë, e pinte me shije koka-kolën, stjuardesa ia solli një tabletë të bardhë, pak më parë i ishte ankuar se ka dhembje koke. Vidiçit prapë i dhembte koka, e dinte fare mirë se kush është shaktar për këtë. Kur stjuardesa lajmëroi se avioni nuk do të zbresë fare në Cyrih, ai ndjeu një lehtësi të madhe, nisi t'i pushojë dhembja e kokës. Mjeku Vidiç dyshonte se do ta arrestonte Interpoli në Cyrih. Shikoi prapë në dritare, lumenjtë ishin prapë si vija të zeza uji, por nuk ishin të ngrirë, ai donte ta shihte Savën e vet, sytë iu mbushën Savë, e ndezi edhe një cigare, stjuardesa eci drejt tavolinës së tij, ia rregulloi edhe më mirë mbështetësen e bardhë të karrigës, e luti që të mos pijë duhan, se nuk kishte më barna që ia pushojnë dhembjet, mjeku qeshi

tinëzisht, atë qeshje e hetoi stjuardesa, e ktheu kokën prapa, u pendua që i shërbueu një njeriu që i dukej enigmatik.

Avioni zbriti në aeroportin e Beogradit, për çudi të të gjithë udhëtarëve autobusi që duhej t'i bartte deri në qendër të qytetit nuk kishte ardhur ende, bagazhi i avionit ishte tashmë i zbrazët, në të hynin udhëtarë të tjera. Para mjekut Vidiç u ndal një veturë e kaltër, iu duk atij edhe më e kaltër se vetë lumi Savë, njerëzit me uniformë të kaltër e puthën mjekun Vidiç, ai ndezi edhe një cigare, vutura nxitonë. Njerëzit me uniformë të kaltër i treguan mjekut Vidiç se në fshatin Prekaz një shqiptar e ka bërë shtëpinë e vet kala, është ngujuar në të, është i armatosur shumë, edhe babanë e vet e ka të armatosur, nga shtëpia ime, bërtet plaku, nis prapë Shqipëria, i biri i tij pohon me kokë, vret sa mundet njerëz tanë, të gjithë i kanë këmishat me pancir, kanë plumba të fortë babë e bir, po i shpojnë edhe ato këmisha, nëse nuk e bëjmë rrafsh me tokë atë shtëpi, nisi të krijohet Shqipëria, shtëpitë e shqiptarëve janë si rrushi, i kemi analizuar mirë, kur piqet rrushi

në një gixhë, piqet edhe në tjetrën, pastaj piqet tërë vreshta, vijnë ushtarët e Kombeve të Bashkuara, zbresin më parë nga maja e Bjeshkëve të Nemuna ushtarët nga Tirana, bëhet ushtimë e madhe, na ik nga dora Kosova. Ç'mendim ke për këtë mjeku Vidiç? Nuk kam mendim fare për këtë, por një gjë e di: prekjani me majë të thikës themelet e kësaj shtëpie, siç ia preka unë Liridonit. Majën e thikës duhet ta fshehni, e për ta fshehur këtë më parë dërgoni sa më shumë policë shqiptarë, le t'i vrasin së pari policët shqiptarë, se edhe ashtu ata duhet të jenë të vrarë edhe nga dora jonë, se s'kemi besim në ta, pastaj do t'i vajtojmë në gazeta dhe në TV policët shqiptarë, edhe populli do të vajtojë, kur arrin kulmin vaji, atëherë ne nxjerrim tinë-zisht majën e thikës tjetër, gjuajmë bomba nga helikopteri. Ide e mirë mjeku Vidiç. Nga idetë e mira rrojnë gjashtë vellezërit dhe dy motrat e mia, rron tërë kjo botë nga idetë e mira, po ju ua keni mësuar emrat atyre që gjuajnë plumba kundër shtetit tonë? Nebih e ka emrin plaku, i biri i tij është Tahir Meha. Ky Tahir Meha është brezi i dytë apo i tretë

i familjes Meha, ajo familje që e pat një plak që luftoi krah për krah me Azem e Shote Galicën. Një rrënë e fortë, por para forcës sonë s'ka rrënë e fortë...

Sorra e zezë prapë e hapi sqepin në formë të shkronjës V. Prapë Alban Hylloshit i shkuan sytë në atë shkronjë, mjeku Vidiç dilte nga vetura, sqepi i sorrës mbyllej prapë... Mjeku Vidiç e cte këmbë mbi urë të Savës, diku në thellësi të këtij lumi shihte fytyrën e vet, i mbylli sytë që të mos e shihte më, shtatë hapa eci me sy të mbyllur, u ndesh me një plakë që mbahej në shkop, idiot, i tha plaka, gati ma shkele këmbën e sëmurë, ku i ke sytë. Po në ballë i kam sytë, mori gruña e mirë. Po t'i kishe në ballë, do të ecje në anën tjetër të trotuarit të urës, pse ke dalë në këtë anë! Vërtet paskam gabuar, dhe u kthyesh prapa mjeku Vidiç, plaka i tha që të mos i afrohet.

Mjeku Vidiç e cte shtatë-tetë hapa përtej plakës, doli te zebra e zezë, eci kujdesshëm nëpër zebër, hyri në udhën e vet, prapë e shikonte lumin, në fund të tij shihte një plakë që e cte me krrutë... Kush nuk më

ka qortuar sa plaka, tha mjeku Vidiç, nuk më ka qortuar as zonjusha S., burrit të së cilës ia preka me majë të thikës zemrën. Ai eci prapë nëpër trotuarin e urës së lumiit Savë, pranë plepave po e priste një veturë e bardhë, ishte ambulanca e spitalit, ai hyri në të, boria e saj u dëgjua pas pak në Dedinje.

Mjeku Vidiç hyri në zyrën e trashëgimtarit të Sundimtarit të kuq...

Alban Hylloshi prapë e shikonte sqepin e hapur të sorrës, si duket ajo e hetoi shikimin e tij, ose të kolliturën e tij, sepse iku trembshëm, ndal majë një lisi tjetër, prapë e hapi gojën, shkronja V. edhe mbi këtë lis bënte pushtet. Mbrëmja po afrohej, sorra e zezë nuk dukej më në asnjë lis, ndoshta u fsheh si mjeku Vidiç. Alban Hylloshi u kthyte në shtëpi, e shikoi fotografinë e Liridonit, në sytë e tij si deti prapë shikonte një datë: 17 janar 1982.

Ishte muaji korrik, viti 1995.

Alban Hylloshi kishte bërë të gjitha përgatitjet për të shkuar një prozë për Liridonin, kishte shkuar për të tretën herë te varri i tij, kishte lexuar të gjitha veprat që i

kishte lënë pas, ishte mahnitur me zërin e kitarës në duar të vajzës së tij, edhe më shumë ishte gjuar kur kishte dëgjuar rrëfimin e djalit të tij për ligjet që i kanë shtetet e ndryshme të botës, kishte lexuar prapë Kanunin e Lekës, ishte ulur për të shtatën herë para shuplakave në faqe të nënës së Liridonit, nesër do të shkoj në fshatin Llau-ushë, dje isha në Rezallë, tha nënë Ajkuna, po i falin gjaqet të gjithë shqiptarët, po hapen dyert e kullave prapë, po shkrihen drynat e shtëpive, Anton Çetta po na prin, priftë mbarë ai gjithmonë, e bekoftë Zoti, edhe Liridoni e ka dashur shumë Anton Çettën.

Alban Hylloshi i kishte shënuar tri data edhe në një fletore të punës: 17 janar 1467... 17 janar 1982... 13 maj 1982...

Nënë Ajkuna me sytë e vet kishte parë kullën e rrënuar të Tahir Mehës në Prekaz, si nuk e ke parë ende ti, Alban Hylloshi, më qortoi. Mirë që më qortoi, qortimi i saj është një mësim përmua, por t'i them nënë Ajkunës se nuk po kam forcë shpirtërore ta shoh të rrënuar kullën e Tahir Mehës, ajo do të thoshte, por çfarë mjeku je ti kur të mungon

kjo forcë. Mjeku Vidiç jo vetëm që ma vrau Liridonin, siç ia vrau edhe vëllanë dhe shokun e tyre të pandashëm, por i çoi në Prekaz gjashtë vëllezërit e vet dhe dy motrat që të vrasin një plak dhe birin e tij. I vranë në shtëpi të tyre, ku mund të shkonin përtej pragut të shtëpisë. Po ai ishte mjek vrasës, nënë Ajkunë - e shikova kitarën që e kishte varur në muri, më dukej se prapë po dëgjohet zëri i Liridonit, po ai vërtet dëgjohet, kush tha se ai zë s'është më, - thashë në heshtje, dola nga shtëpia e nënë Ajkunës, eca drejt Prekazit, më dukej se në një lëndinë nuk ishte vetëm një lis, por ishin shumë lisa e Ahmet Delia po mbështetej prapa një lisi...

Mortaja e zezë vinte nga veriu...

Një plakë qet kokën në dritare, tregon se djemtë e saj janë në arë, e kanë mbushur traktorin me duaj të grurit, tash vijnë, dreka është gati, dera e kullës është e hapur...

Nuk kemi kohë, i them unë plakës, që më dukej si një rojtare e mistershme e shtëpive, e kishte hequr shaminë nga koka, flokët e saj të bardha edhe më misterioze e bënin, ndoshta numri i kullës ku ishte hapur një

dritare e bënte misterioze: i dukej vetëm koka. Ajo bëri me dorë nga kulla e rrënuar e Tahir Mehës, po i rrëxohen edhe muret që s'janë qëlluar me predha, tha ajo, medet pse po i humb edhe themeli kësaj shtëpie, tha plaka dhe futi kokën brenda, i mbylli kapakët, kullës i dukeshin muret që merrnin diellin e nxehthë, e reflektonin edhe në sytë e mi, eca drejt kullës së rrënuar, dëgjohej prapë një ushëtimë, para se të hyj në mes të mureve të rrënuara iku një sorrë e zezë, kishte qëlluar frikacake, u ndal majë një trupi të dardhës, më dukej se edhe kjo sorrë e zezë qëllimisht e hapte sqepin për të krijuar shkronjën V. Vidiçi kishte hyrë edhe në Prekaz, kishte rrënuar çdo gjë në kullën e Tahir Mehës, i kishte shkelur me këmbë edhe lugët e drurit, i kishte përplasur për tokë edhe pjatat, sofrën e kishte qëlluar në shtatë vende, shtatë vrima i kishte sofra: kishte qëlluar vëllai i madh i mjekut Vidiç, kishin qëlluar edhe pesë vëllezërit e tjerë, njëra motër e tij nuk kishte qëlluar fare as në çatinë e kullës. Unë s'e kam me gjak, as s'e

kam me fis asnje vëlla të mjekut Vidiç, as motrën e tij nuk e kam motër, unë jam e një fisi tjetër, unë jam e një gjaku tjetër, unë as nuk flas si ju, as nuk mendoj si ju, mund të më vritni shtatë herë, shtatë herë do të flas të vetmen fjalë: "Dora ime nuk e sulmon dorën e vëllait tim..."

**Alban Hylloshi fshiu djersët nga balli.**

Dielli nuk ishte fajtor pse ai është djer-situr aq shumë. Djersët e tij ishin të ftohta, ia preknin edhe sytë, ai prapë i shikonte muret e rrënuara të kullës. Pranë oxhakut të shtëpisë ishte rritur bari. Bari kishte mbuluar edhe anën e murit prej nga kishin qëlluar me plumba dhe predha vëllezërit dhe motra e Vidiçit. Ajo pjesë e shtëpisë së Tahir Me-hës ishte më e plagosura, ajo përngjante në lagjen Gjëmëmadhe... Këtu ishte një shtëpi e rrënuar, atje ishte një lagje me gjëmë të madhe, një hark i lidhte dy plagë... Djersët në ballin e Alban Hylloshit shtoheshin edhe më shumë. Një vit më parë, thoshte ai në heshtje, me dorën time e kam lëshuar në varr nënën që më vdiq, nuk kam pasur kaq shumë djersë, ç'është sot me mua, mos ka hyrë

tinëzisht mjeku Vidiç edhe në muret e rrënuara të kësaj shtëpie, nuk po ia shoh majën e thikës... O, nuk kam frikë, frikë nuk kam në shpirtin tim fare, por një fole e sorrës së zezë mbi murin e oxhakut gati m'i vërboi sytë. Sorra e zezë e ka ndërtuar folenë, ka ikur, nga mali na shikon, unë do të hyj në të gjitha malet, do t'ia këputi shkronjën V sorrës së zezë...

Kur nisa ta shkruaj prozën time, Urani më dukej si Liridoni, e tash që erdha në Prekaz... Asgjë nuk ka ridryshuar në mua, prapë në këto mure shoh tri data: 17 janar 1467... 17 janar 1982... 13 maj 1982.

Që nga shtatëmbëdhjetë janari i vitit 1982 e deri më 13 maj 1982, mjeku Vidiç do të ketë rrënuar edhe shumë shtëpi, maja me helm e thikës së tij do të ketë prekur shumë zemra, prapë do të ketë hipur në avionë të shpejtë, ah! këta avionët që e bartin mjekun Vidiç nuk janë tjetër, pos sorra të zeza. Asgjë nuk paska mbetur nga kulla e Tahir Mehës, paj... dhe u pendua pse i foli këto fjalë Alban Hylloshi. Ai deshi t'ia kthente shpinën kullës së rrënuar, diçka e kishte lidhur për ato mure

të saj, diçka kishte më shumë forcë se majë e thikës që ia kishte therrë zemrën Liridonit, ai prapë shikonte, ecte me sy nga kulla. Ecte me sy nga kulla e nuk rrëxohej, ai nuk ishte njeri me sy përpara dhe prapa, ai kishte fituar edhe një palë sy sot, ai prapë ecte, nuk e lëshonte kulla, prapë nuk e lëshonte, ai harroi se duhet të kthehej në Prishtinë, mbrëmja po afrohej, ai prapë ecte, dikush u shtang në këmbë, kishte hetuar diçka që e lidhi aq shumë për kulle, ai u bë një me murin që nuk ishte rrënuar ende, ishte një pjesë fare e vogël, e preku me dorë atë pjesë, e ngriti edhe njëherë dorën, e përkëdheli një copë të llamarintë, aty ishte një numër, Alban Hylloshi nuk iu besonte syve të vet, donte ta prekte edhe njëherë me dorë, donte ta lexonte edhe një herë numrin në llamarinë, i pyeti dy bashkudhëtarët e vet: "Më bëjnë sytë, apo ky është numri shtatë?"

- Numri shtatë i shtëpisë së Tahir Mehës, - tha njëri prej bashkudhëtarëve të tij.

- Numri shtatë është shenjë se ky truall

uame te perëritet, - tha bashkudhëtari tjetër.

Që të tre e shikuan edhe njëherë numrin shtatë, pastaj hipën në veturë, në të gjitha shenjat e komunikacionit lexonin numrin shtatë...

Edhe në gjumë Alban Hylloshi dëgjonte zërin e kitarës së Liridonit dhe bisedonte qetë-qetë me numrin shtatë...

Numri shtatë i shtëpisë së rrënuar ishte ngjitur në muri në dorë të Tahir Mehës. As ai nuk kishte pandehur se një ditë do të rrënohet tërësisht shtëpia e tij, por do të mbetet varur në pjesë të murit vetëm numri shtatë. Edhe ky numër shndërrrohej në kitarë, sa më shumë që furtuna e sulmonte, aq më shumë i shtohej zëri numrit shtatë...

Numri shtatë në një pjesë të metaltë...

Numrit shtatë i rritej edhe më shumë zëri:

"Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Presheva... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Drenica... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Du-

kagjini... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Ulqini... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Llapi... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Shala... kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Gollaku... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Tetova...Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Karadaku... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Hasi... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Ruggova... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë ana e Gjilanit... kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Dibra... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Shkupi... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë ana e Lumthatit...Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Gostivari... Kukudhët janë ata që e përhapën fjalën se Liridonin e ka vrarë Deçani. Kuku-

dhët janë ata që vraponin pas zërit të kitarës së tij, donin ta shuanin atë, donin të krijonin dyshime dhe përçarje të mëdha në tërë Shqipërinë e pushtuar nga sllavët, por ishte Shqipëria e lirë, e në të Tirana e lirë, e cila e kishte një spikere të re dhe me zë të orëve të maleve tonë, e lexonte pa asnjë gabim "Baladën..." e Ismail Kadaresë. Që nga Presheva e deri në Gostivar njerëzit nisën të marrin frymë lirisht, dhembja prapë ishte tepër e madhe për Liridonin, por askujt më nuk i zihej fryma, të gjithë njerëzit e Shqipërisë së pushtuar gati sa nuk e sëmurën nga astma kolektive. Ishte droja që astma ta mbyste tërë një Shqipëri, iku astma, u dëgjuat prapë zëri i kitarës...

Kitarja dilte edhe nga numri shtatë i shtëpisë së rrënuar të Tahir Mehës, i trëgonë Alban Hylloshit edhe në gjumë se vrasësi i Liridonit ka nisur të vrasë edhe Slloveninë, nuk është ngopur me gjak atje, ka zbritur në Kroaci, Kroacia është mbushur me varre, vrasësi i ka hipur kalit të përhimtë të natës, ka hyrë në Bosnjë, është përbetuar që t'i vrasë të gjithë Boshnjakët, siç do ti vrasë,

kishte ngritur zërin ai, edhe ata që nuk i puthën këmbët e mia në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Edhe njerëzit e mi brenda Serbisë do t'i vras nëse nuk mbledhin mend dhe nuk pajtohen të thonë se Ballkani është tokë e vogël për Vidiçin. Vidiçi duhet të ketë hapësirë edhe më të madhe, do të dalë edhe në Hungari e në Rumani, do të merr edhe vise të thata dhe një pjesë të detit edhe në Greqi, turrin nuk do ta ndalë deri në Sofje, e pastaj nisem nga veriu dhe ia them nja dy fjalë edhe Austrisë, se Austria kurrë nuk më ka pëlqyer. Vidiçi, do t'iu them të pabindshmve, është i fisit hyjnor, do të thotë jam i atij fisi që duhet ta sundojë tërë Evropën, andaj ç'kanë këta të fisit tim që më kundërshojnë. Do t'i vras, siç kam vrarë Liridonin, dhe prapë do ta bindi botën se unë nuk jam vrasës. Jo vetëm Shqipëria, por tërë bota do të pyesë: "Kush e vrau Liridonin?"

Kukudhët janë ata...

Unë jam një pjesë e metaltë, i bëj roje shtëpisë së rrënuar të Tahir Mehës, jam vetë numri shtatë, nuk di si ka hyrë në mua zëri i kitarës së Liridonit, por ai ka hyrë dhe unë

mund të bie një ditë në tokë, mund edhe të rrëmbehem nga kukudhët, mund edhe të shkelem me këmbë nga policët dhe ushtarët e shumtë të Vidiçit, por zëri im, pra zëri i kitarës së Liridonit, nuk do të shuhet kurrë. Ai zë nuk do të shuhet as atëherë kur nënati tona nuk do t'i pagëzojnë fëmijët me emra klithës... tërë Shqipëria e lirë dhe e bashkuar do ta ruajë atë zë. Ai zë do të tregojë se edhe më 17 janar 1467, kur vdiq Skënderbeu, tërë Evropa derdhi lot për Të, u pikëllua tërë bota, por vetëm i pari i Vidiçit u gjëzua. Iku mbretëria e Skënderbeut, tha i pari i Vidiçit, do të lindë mbretëria ime. Ajo lindi, u rrit në tokat e huaja, andaj tërë bota u ngrit në këmbë edhe më 1995 për ta ndalur luftën që e kishte shkaktuar Vidiçi, por ajo nuk ndalej se nuk ndalej. Në fund të këtij viti botë e kuptoi se më 17 janar 1467 u gjëzua për vdekjen e Skënderbeut vetëm i pari i Vidiçit. Bota nganjëherë i kuption ca gjëra me pesë shekuj vonesë, andaj ata pesë shekuj vrasësi paguan shumë kukudhë për ta fshehur dorën e vet, por është Radio-Tirana që i tregon botës emrin e vrasësit. Vrasësi Vidiç ngjitet prapë

në shkallë të avionit, me të hollat që i ka fituar nga vrasjet e njerëzve i paguan jo vetëm kukudhët, por gazetarët, diplomatët gjysmakë dhe laviret e kancelarive të mëdha për të shkruar kundër Ismail Kadaresë, që ai të mos e merrë Çmimin Nobël për letërsi. Vaj halli për tërë botën nëse edhe këtë çështje kaq të ndërlikuar dhe kaq të pashme njëkohësisht e merr vesh pesë shekuj më vonë. Edhe unë kur isha vetëm numër shtatë në llamarinë, pra kur më mungonte zëri i kitarës së Liridonit, i bëja vetes pyetje: "Kush e vrau Liridonin?", por zëri i kitarës m'i sqaroi të gjitha andaj duhet ta kesh të qartë edhe ti, Alban Hylloshi, - foli numri shtatë i shtëpisë së rrënuar të Tahit Mehës. Alban Hylloshi u zgjua nga ëndrra, ishte djersitur, e shikoi murin, nga roletat depertonte dielli, ishin ca figura të dashura në muri.

- Kush e vrau Liridonin? - tha ai prapë, ndonëse asgjë nuk kishte mbetur enigmatike.

Figurat e diellta lëviznin drejt derës, dielli ngjitej lart.

## **SHËNIME PËR AUTORIN**

Flori Bruqi u lind më 1952 në Isniq të Deçanit. Shkollën fillore e kreua në vendlindje, të mesmen në Pejë, kurse studimet në Beograd.

Poezi, tregime dhe shumë fejtone i botoi në revista dhe në gazeta që dalin në gjuhën shqipe.

Flori Bruqi tash jeton dhe punon në Prishtinë.

Deri tash ka botuar këta libra:

"Zjarri i diellit", poezi, 1995.

"Ndërgjegjja", roman 1995.

"Vrasësit e Liridonëve", është vepra e tij e tretë.



Flori Bruqi

VRASËSIT E LIRIDONËVE

Redaktor teknik  
dhe realizues kompjuterik  
**Enver Sylejmani**

Shtypi  
**grafoprint**  
Prishtinë  
1996